



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.06.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Albana Vokshi – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të datave 30 maj, 4 dhe 6 qershor 2018.
2. Seancë dëgjimore për dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare dhe nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në lidhje me mbylljen e menjëhershme të aksesit të faqes satirike online www.kryeministri.com.

Marrin pjesë:

Albana Vokshi, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Adelina Rista, Bujar Çela, Luçiano Boçi, Luan Baçi, Romeo Gurakuqi, Valentina Duka, Shezai Rrokaj, Kejdi Mehmetaj, Nora Malaj, Besnik Baraj (zëvendësues), Anduel Xhindi (zëvendësues), Endri Hasa (zëvendësues) dhe deputetë të tjerë të opozitës.

Mungon:

Fatmir Velaj, Fadil Nasufi.

Të ftuar:

Ilir Zela – Kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike e Postare

Vilma Tomço – Drejtore e Përgjithshme e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

Elisa Stamo – Përgjegjëse e Sektorit të Akreditimit në Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike

HAPET MBLEDHJA

Albana Vokshi – Mirëdita!

Meqenëse kuorumi është plotësuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, se po fillojmë! Jemi gati?

Meqenëse jemi pothuajse të gjithë prezent, po hap mbledhjen e sotme të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi miratimin e procesverbaleve të datave 30.05.2018, 04.06.2018 dhe 06.06.2018, të cilët janë dërguar nga Ariana. Në qoftë se keni vërejtje, ju lutem, kontaktoni me Arianën.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka vërejtje për procesverbalet? Biem dakord? Dakord.

Miratohej të tria procesverbalet.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi seancën dëgjimore për dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike e Postare dhe nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike në lidhje me bllokimin e aksesit të faqes satirike online www.kryeministri.com.

Kjo është një dëgjuesë që e kemi shtyrë në kohë, sepse mbledhjen e parë, pavarësisht se ishte kërkuar nominalisht, sikurse edhe Rregullorja e përcakton, drejtuesi i AKEP-it nuk u paraqit, por dërgoi vartësit e tij. Për këtë arsye, me konsensusin e të gjithë deputetëve të komisionit, vendosëm ta bënim sot dëgjuesën, por duke u bazuar edhe në informacionin që zoti Zela na dërgoi me shkrim në lidhje me urdhrin e marrë nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike. Pra, urdhri për mbylljen e kësaj faqeje kishte ardhur pikërisht nga ky Autoritet. Kështu, edhe me sugjerimin e të gjithë deputetëve, menduam se nuk do të kishte sens nëse do t'ju ftonim veç e veç. Kjo është arsyeja pse ju kemi thirrur të dyve sot.

Para se t'ju kaloj fjalën, dua të vë sërish në dukje se na ka mbetur edhe vetëm një javë nga vendimi shumë i rëndësishëm për të gjithë qytetarët shqiptarë nëse do të hapen ose jo negociatat me Shqipërinë, më saktë, kanë ngelur vetëm shtatë ditë nga marrja e këtij vendimi kaq të rëndësishëm për të gjithë qytetarët shqiptarë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse, po e përsëris, se ka mbetur vetëm një javë, pra vetëm shtatë ditë, dua të ngre shqetësimin se nga ana e qeverisë nuk është hedhur absolutisht as edhe një hap në lidhje me plotësimin e kriterëve të vendosura, të cilat do të jenë edhe përcaktuese për hapjen e negociatave, duke filluar nga kriteri nr. 1, që është kriteri politik, për të cilin ne sot do të diskutojmë, pasi edhe liria e shprehjes, liria e medias në një vend të caktuar është prerogativë për procesin e integritetit.

Dua të përsëris këtu edhe atë çka komisioneri Hahn, në nëntor të vitit të kaluar, deklaroi në Shqipëri se hapja e negociatave do të varet nga liria e medias dhe e shtypit në çdo vend që aspiron të futet në procesin e hapjes së negociatave.

Me keqardhje, konstatoj se në këtë drejtim janë bërë shumë hapa pas, duke filluar që nga dhuna e ushtruar ndaj pronarëve të medieve, ndaj vetë medieve, ndaj gazetarëve: fyerje, shantazhe, për të vijuar me mbylljen e portaleve, që nuk i kontrollon dot qeveria dhe hapjen e shumë portaleve, të cilat u takojnë ministrave apo kryetarëve të bashkive të maxhorancës, të cilat në pjesën më të madhe të kohës ose përhapin *fake news*, ose bëjnë luftë të hapur ndaj miqve të Shqipërisë, gjë që e rrënon, si të thuash, edhe pjesën e dhënies së informacionit të duhur, përçimit të informacionit të duhur, atë çka është edhe roli kryesor i medias në çdo vend, pra informimi i publikut dhe në bazë të këtij të fundit, edhe qytetari ka pastaj të drejtën e tij të mbajë një qëndrim ndaj qeverisjes apo keqqeverisjes.

Pikërisht rasti i fundit flagrant është mbyllja e aksesit të portalit satirik www.kryeministri.com, çka tregon se vendi jo vetëm nuk po bën hapa para në drejtim të lirisë së medias dhe të shtypit, duke shkelur kështu njërin prej kriterëve kryesore, atij politik, për t'u plotësuar për hapjen e negociatave, por, përkundrazi, po bëhen shumë hapa pas, gjë që është në shkelje flagrante jo vetëm të konventave për të drejtat e njeriut, por edhe të nenit 22 të Kushtetutës.

Ky ishte, si të thuash, një sensibilizim për deputetët e maxhorancës, të cilët duhet t'i bëjnë thirrje Kryeministrit, t'i bëjnë thirrje qeverisë që në këto ditë që kanë mbetur të fillojnë të tregojnë se janë seriozë në lidhje me hapjen e negociatave; në këto shtatë ditë që kanë mbetur të fillojnë t'i plotësojnë kriteret njëri pas tjetrit (kriterin politik e të tjerë); të fillojnë luftën ndaj krimit, bandave, ndaj trafikut të drogës, si dhe të respektojnë të drejtat e njeriut. Pra, të bëjnë atë çka duhet të bëjnë, në mënyrë që, pas një jave, ne të kemi një vendim pozitiv për hapjen e negociatave. Ne si opozitë jemi të vendosur ta bëjmë detyrën tonë çdo ditë edhe këtu në komision, edhe në çdo hapësirë tjetër për t'ju kujtuar juve që duhet të veproni, sepse kanë mbetur shumë pak ditë. Qytetarët nuk meritojnë një qeveri, që po i mban peng. Ju jeni pengu,

që po i pengon qytetarët shqiptarë për të mos qenë të barabartë dhe dinjitozë, ashtu si qytetarët e vendeve të tjera, për të pasur vendin që na takon në BE, ashtu si vendet e tjera.

Urdhëroni, Milva, për procedurë!

Milva Ekonomi - Faleminderit, zonja kryetare!

Mirë se keni ardhur të gjithë!

Natyrisht, unë nuk kam të drejtë të mendoj se si do ta bëjë aksionin politik opozita, sepse ajo e di vetë se si e bën, por unë besoj se një nga gjërat që duhet të dimë të gjithë bashkë në këtë komision, është se duhet të zbatojmë kalendarin e aktiviteteve për të cilin ne biem dakord. Ne nuk mund t'i shmangemi dot Rregullores së Kuvendit për të cilën kemi votuar të gjithë së bashku, sepse kjo tregon që ne nuk jemi akoma gati për të bërë që të funksionojë siç duhet shteti i së drejtës.

Prandaj, unë mendoj se një nga gjërat që duhet të kemi parasysh në diskutimin e sotëm, është që mbledhja e sotme është një mbledhje e vendosur në kalendarin e aktiviteteve të këtij komisioni, që para 10 ditësh. Ndërkohë, ramë dakord të gjithë së bashku që në javën e kaluar nuk do të kishte mbledhje komisioni. Ju përdorët hapësirën e këtij komisioni për të bërë një dëgjese të PD-së me një grup artistësh. Natyrisht, është e drejta juaj ta bëni dhe këtë të drejtë nuk jua kufizon asnjëri, por mos përdorni hapësirën e komisionit! Këtë mund ta bëni edhe në Kuvend, në sallën e konferencave, edhe pranë partisë suaj, se ka vend për konferenca.

Kështu, unë do të isha mbështetëse e aktiviteteve tuaja, por jo kur i bëni në emër të të gjithë grupit, por vetëm në emër të palës që ju përfaqësoni.

Nga ana tjetër, dua të them se është shumë e domosdoshme për të mirën e punës, që për aktivitetet që ne biem dakord në kalendar, të jenë të ndjekura dhe të zbatuara nga të gjithë ne.

Për sa i takon asaj që thoni, se shqiptarët po presin me padurim hapjen e negociatave për Shqipërinë, unë besoj se të gjithë shqiptarët po presin me padurim. Natyrisht, PS-ja dhe qeveria që drejton vendin, po bën përpjekjen maksimale për ta arritur këtë. Ne, si maxhorancë, kemi bërë përpjekjet maksimale për të vënë në funksionim shtetin e së drejtës. Padyshim, reforma në drejtësi ishte një shembull i qartë i asaj që kur ka një dëshirë të mirë, gjërat të shkojnë përpara. Për këtë kemi marrë nota pozitive nga ata që na vlerësojnë.

Para se ju të gjykoni se si do të jetë e ardhmja e Shqipërisë pas 28 qershorit, besoj se duhet të kemi durimin dhe besimin që Komisioni European dhe BE-ja do të bëjnë punën që u takon të bëjnë për sa i përket Shqipërisë, në lidhje me të gjitha raportimet që kanë nga të gjithë reporterët e tyre, të cilët ndodhen në territorin e vendit tonë dhe herë pas here kryejnë misione

dhe kanë parë ecuri si në fushën e së drejtës, si në fushën e lirive, si në fushën e medieve, si në fushën ekonomike, ashtu edhe në respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare.

Kështu, unë besoj se përtej retorikës sonë politike, ka një retorikë që është retorika e veprimit, e cila matet me indikatorët e performancës. Ne do të presim. Kemi kohë për të pritur për këtë.

Lidhur me lirinë e medieve, dua t'ju bëj me dije se edhe në komision, edhe në *web page* ka një raport të hartuar nga Instituti Shqiptar i Medieve për një projekt të thirrur nga BE-ja për situatën e medieve në Shqipëri. Janë 27 indikatorë, për medien shqiptare të caktuar mbi bazën e një rregulloreje të vitit 2008, që masin situatën e medieve në Shqipëri dhe nga këta, 7 indikatorë janë të përputhshëm plotësisht në Shqipëri, disa indikatorë kanë probleme të vogla dhe disa të tjerë kanë probleme. Kështu, unë nuk besoj se Shqipëria me këtë situatë, ka një medie që nuk funksionon e lirë. Unë besoj se në këtë situatë, me këtë vlerësim që KE-ja i jep Shqipërisë, media shqiptare ka progres, ka probleme që ka e gjithë media globale sot, të cilat ajo përpiqet çdo ditë t'i zgjidhë sa më mirë.

Mendoj se komisioni ynë ka detyrimin që këtë raport të hartuar edhe në gjuhën angleze, edhe në gjuhën shqipe, ta mbajë si Bibël në dorë dhe ta përdorë sa herë që do të suportojë medien.

Dëgjesa që kemi sot është një dëgjese, që ka ardhur si rezultat i konkluzionit të punës së përbashkët. Kemi rënë dakord se kjo është një dëgjese e dobishme për shoqërinë, për të parë se si funksionon shteti i së drejtës dhe prandaj jemi të gjithë këtu, për zbatimin e një kalendari, që është dakordësuar 10 ditë më parë.

Faleminderit shumë!

Albana Vokshi – Faleminderit!

Dua t'ju kujtoj se...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur të vijë koha, do t'ju japim edhe atyre. Mos u shqetësoni!

Nuk duhet të lëmë disa dezinformime! Dëgjesën e kemi kërkuar ne, deputetët e opozitës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk u paraqit drejtuesi i institucionit, i cili ishte kërkuar nominalisht.

E dyta, ju kam thënë të lexoni Rregulloren, e cila e ka shumë të qartë. Për sa kohë nuk është vendosur në kalendar, është Rregullorja, e cila përcakton kalendarin, nëse kërkohet me 1/3 e firmave. Ju lutem fiksojeni këtë! Po jua them që të jenë të qartë të gjithë. Me 1/3 e

firmave të deputetëve automatikisht futet në kalendar dhe nuk ia lë në dorë maxhorancës. Këto janë artificat që kanë përdorur kur është shkruar Rregullorja, që të mos ta vendosni ju se kur t'i mbyllet goja opozitës, që të mos vendosni ju, se kur bëhet transparencë apo jo në këtë komision. Nuk e përcaktoni ju, të nderuar kolegë, kalendarin e këtij komisioni!

Ne kërkojmë, çdo ditë mund të kërkojmë dhe çdo ditë do të kërkojmë, sepse do të bëjmë transparencë qoftë për mbylljen e portaleve, qoftë për censurën, sepse Shqipëria po shkon në autokraci.

Kjo është shprehje e diktatorëve. Si mund të censuroni ju portalet, sepse aty bëhet satirë me ministrin e Brendshëm, me Kryeministrin apo me të gjitha postet kyçe në qeveri? Prisni, se nuk mund të përcaktoni ju axhendën e opozitës në këtë komision! Ju lutem, lexoni Rregulloren që të mos futemi në leximin teknik të Rregullores! Aty është shkruar shumë qartë. 1/3 e deputetëve e ka kërkuar këtë dëgjësë dhe ju jeni të detyruar që të vini. 1/3 e deputetëve e ka kërkuar dëgjësë me ministren e Kulturës, 1/3 e deputetëve e ka kërkuar dëgjësë me Erion Veliajn, se do të bëjmë transparencë për puçin kushtetues dhe për shkatërrimin që po i bëni ju shtetit. Ju duhet të jeni këtu, sepse këtë e përcakton Rregullorja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, 12 orë përpara, siç e përcakton Rregullorja, duhet të jeni këtu, sepse ka prioritet axhenda parlamentare. Jemi në një republikë parlamentare. Nëse ju nuk e dini akoma, ne jemi republikë parlamentare dhe nuk jemi republikë kryeministore, që të vendosë Kryeministri edhe për axhendën e parlamentit. Ndaj, këtu dhe në të gjitha komisionet e tjera, bazuar në Rregullore, axhendën e përcakton Rregullorja e Kuvendit dhe juve nuk ju mbetet gjë tjetër vetëm ta respektoni atë.

Po ju bëjmë thirrje prej 7 ditësh: bëjeni Kryeministrin të fillojë të plotësojë kriteret sepse e keni katandisur këtë vend për faqe të zezë. Të paktën ju mos u bëni palë me bandat dhe me krimin! Të paktën ju të distancoheni dhe e keni shansin për ta bërë tani këtë shans. ne, si opozitë po jua japim këtë shans që ta bëni këtë. Distancohuni!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem Vilma, mos u përdor!

Fjalën e ka Luani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem Vilma, mos u përdor!

Luan Baçi – Mbledhja e sotme e komisionit është në vazhdimësi të mbledhjes së para disa ditëve.

Në fakt, kishim thirrur AKEP-in dhe më vjen mirë që sot është prezent drejtuesi i institucionit. Kjo mbledhje u shty për arsyen e vetme, sepse ai nuk u paraqit.

Unë do ta nisja me AKEP-in, sepse ne morëm disa përgjigje me shkrim nga institucioni përkatës për të cilat unë do të thosha (e përsërita edhe në herën e kaluar në mbledhjen e shkurtër që bëmë), se ishin përgjigje me karshillëk, jo të sakta, drejtuar komisionit. Thjesht, përsëritej në përgjigjet e të gjitha pyetjeve, që janë një institucion, që s'kanë fare të bëjmë me këtë vendim dhe, se janë thjesht ekzekutues vendimi, se janë një tip përmbarimi, që zbatojnë një vendim të ardhur nga autoriteti që drejton zonja Tomço.

Në këtë drejtim, kërkoj nga ju, dy autoritetet, të na shpjegoni mënyrën si është vepruar për mbylljen e aksesit të këtij portali *online*. E përsëris “për mbylljen e aksesit”, sepse herën e kaluar na thatë që nuk mbyllni faqe, por akses, edhe pse në pyetjet që ju kishim drejtuar flitej për mbyllje të aksesit.

Zoti drejtues i institucionit, punonjësit që hartojnë shkresat nuk duhet të jenë arrogantë në kthimin e përgjigjeve ndaj kërkesave të opozitës. Kjo gjë nuk është as e nderhme dhe as e drejtë. Opozita e thërret shtetin në komisione parlamentare, kurse maxhoranca jo, me përjashtim të rasteve kur do të bëjë show televiziv.

Mund të na thoni se cilit përkufizim, ligji apo kriteri i referoheni kur thoni që është e paligjshme, cenon privatësinë, del jashtë etikës dhe ligjit?

Keni pasur raste të tjera të kësaj natyre? Nëse po, na i citoni dhe na thoni nëse keni vepruar po me kaq urgjencë sa vepruat për mbylljen e këtij portali apo është zbatuar një tjetër procedurë me diskutime më të hollësishme. Unë jam i bindur që mbyllja e aksesit të këtij portali është e qëllimshme, është një kundërvënie ndaj mediave në përgjithësi dhe portaleve që juve nuk ju shkojnë përshtat, kurse mediat që i keni nën kontroll nuk kanë ndonjë kundërvënie të tillë nga ju si institucione. Këtë e tregoni edhe me ligjin që do të bëni tani për t'i sponsorizuar dhe paguar të gjitha mediat nga taksat e publikut shqiptar duke ia hequr televizionit publik shqiptar dhe kaluar mediave private.

Faleminderit!

Kejdi Mehmetaj – Duke i falenderuar të ftuarit për pjesëmarrjen, edhe pse jemi pak me vonesë nga kërkesa që u kishit bërë, si dhe duke u kërkuar ndjesë për këtë vonesë ditën e sotme, doja të flisja pak për mbledhjen e kaluar ku maxhoranca nuk mori pjesë, si dhe për një propozim që sapo erdhi në adresat tona të *e-mail*-it.

Besoj se nuk është e nevojshme të rikujtojmë edhe një herë që Rregullorja thotë se me kërkesë të 1\3-s së deputetëve të komisionit dhe me një njoftim paraprak komisioni duhet të mbledhet në çdo rast. Besoj se këtu nuk ka vend për interpretim edhe pse

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka shkuar tre ditë përpara, e dashur.

Shkresa është dërguar ditën e hënë dhe ju ka ardhur 24 orë më parë. Sekretaria e komisionit mund ta vërtetojë këtë gjë. Ndaj nuk ka asnjë justifikim për të munguar përveç dëshirës për të munguar.

Pavarësisht debatit politik që kemi, ju ftoj të jeni të kujdesshëm me personalitet që i bashkohen këtij komisioni kur i etiketoni dhe që nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me partitë tona, me luftën tonë politike, sepse të jeni të sigurt që barra e përgjegjësisë së publikut do të bjerë mbi ju.

Histori të tipit “ të përdorur”, “përdoremi” e kështu me radhë, unë nuk besoj se u takojnë personaliteteve, sidomos atyre që ishin prezent herën e kaluar në këtë komision për të folur ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Milva, nuk e kuptoj pse shqetësohesh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Albana Vokshi – Milva, mos bojkotoni mbledhjet e komisionit.

Ju lutem të dëgjojmë Kejdi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kejdi Mehmetaj - E nderuar zonja nënkryetare e komisionit, përgjithësisht karakterizoheni nga qetësia, por fakti që e humbni qetësinë do të thotë që ka diçka që nuk shkon në këtë mes dhe ju e kuptoni këtë gjë.

Nga ana tjetër, sapo na ka ardhur një shkresë me një kërkesë tuajën si deputetë të këtij komisioni, qëllimin e së cilës unë nuk e kuptoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ulqini, e keni firmosur edhe ju shkresën, kështu që është mirë të dëgjoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund të vazhdoj, sepse këta po tregojnë mungesë edukate.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Ulqini po ju drejtohem edhe juve meqë e keni firmosur atë kërkesë. Unë nuk e kuptoj çfarë do të thotë një kërkesë mbi kërkesën. Në momentin që është bërë një kërkesë dhe mbi të vjen një tjetër, unë nuk e kuptoj qëllimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ka njerëz që janë ...

Albana Vokshi – Të lutem, Musa, je burrë në moshë dhe duhet t'i respektosh të rinjtë. Mos vazhdo me fyerje.

Kejdi Mehmetaj – Nuk ka problem, Albana. Ka njerëz që janë të vegjël në moshë dhe kjo është gjë natyrale, ka njerëz që janë të vegjël në mendje dhe ngelen gjithmonë të tillë.

Unë nuk e kuptoj ku qëndron qëllimi i bashkimit dhe i kërkesës, prandaj i ftoj deputetët të na e shpjegojnë. Për ne nuk ka asnjë problem, mund ta bëjmë dëgjuesën edhe së bashku, por të jeni të sigurt që as ministrja dhe as kryetari i bashkisë nuk do të shpëtojnë nga opinioni publik dhe e vërteta e gjithë kësaj situate. Edhe sikur të merrni të gjithë qeverinë këtu, përfundimi do të jetë i njëjtë.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Po, Bujar.

Bujar Çelaj – Faleminderit!

Është bërë e rrugës që të mos diskutojmë më për rendin e ditës. Për këtë gjë po habiten edhe mediat, por ne të maxhorancës kemi fat, sepse i kemi pas kurrizit.

Sot konstatoj me keqardhje që ju të gjithë si parti keni probleme me aritmetikën.

Na ndajnë plot dhjetë ditë nga vendimi për hapjen e negociatave dhe unë ju them atyre që e duan hapjen e negociatave që ai proces e ka marrë notën 10.

Albana Vokshi – Kush e vuri këtë notë, Kryeministri?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bllokimi juaj satirik ose puna jonë mund ta bëjë 10 me yll ose 10 me minus.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Mos u bëni absurd.

Bujar Çelaj – Pse ju i dini të gjitha?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

A ka mundësi të sillesh një herë si kryetare komisioni? Pse nuk e doni hapjen e negociatave? Ju pasqyroni dëshirën që negociatat të mos hapen.

Albana Vokshi – Ju keni kapur gjykatat, prokurorinë, po ushtroni presion mbi pushtetin qendror dhe atë lokal.

Bujar Çelaj – A ka mundësi të mbaroj?

Albana Vokshi - Lërimi institucionet e tjera të bëjnë punën e tyre

Bujar Çelaj – Ju nuk të jepni të drejtën e fjalës kur jeni në opozitë, mendo se çfarë bëni në maxhorancë. Ky popull u lodh me ju, sepse ju të mohoni të drejtën e fjalës. A ka mundësi ta mbaroj fjalën? Ne kemi ardhur në këtë mbledhje për një rend dite të caktuar. Vërtet ju keni bërë një kërkesë me 1/3, por neni 34 i Rregullores e shpreh qartë që mbledhjet e komisionit nuk zhvillohet pa 50+1 të anëtarëve prezentë. Ju shprehni dëshirën për ta bërë, por ne nuk jemi prezentë.

Vazhdoni kur të doni bëjeni mbledhjen, por unë mendoj të mos zgjatemi, sepse u bëmë të bezdisshëm për të gjitha dikasteret, madje kërkoj falje në emrin tim personal që i lodhim, i sfilitim dhe asgjë nuk bëjmë.

Albana Vokshi – Mos censuroni, zbatoni Rregulloren dhe mos bojkotoni! Këto bëni ju! Hajdeni në mbledhje, siç e përcakton Rregullorja!

Endri, për procedurë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Çfarë halli ke? Unë po pyes nëse e doni fjalën për procedurë apo për diskutim?

Ismet Beqiraj-Zonja kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të më dëgjosh patjetër!

Zonja kryetare, ne nuk na provokon dhe nuk na nxeh dot. Ne e dimë historinë e fasadës politike që ju doni të shkarkoni, por, ju lutem, kemi një rend dite dhe unë po pres që zotëria që ka ardhur të pyetet nga ju dhe nga ne.

Albana Vokshi- A e dini rendin e ditës?

Në rendin e ditës është diskutimi pse qeveria po censuron.

Ismet Beqiraj- Ju e keni si fazë nxehje këtë.

Albana Vokshi – Në rendin e ditës është pse Edi Rama po përdor agjencinë për të censuruar, për të mos bërë transparencë të lidhjes së vëllait të ministrit me trafikun e drogës. Kjo është çështja, pikërisht censurimi që i bëhet transparencës se çfarë ka bërë ish- ministri i Brendshëm me bandat dhe me drogën. Kjo është çështja. Nëse ti nuk e kupton, nuk është problemi im. Na lër të shpjegojmë pse një kryeministër diktator po censuron mediat!

Ismet Beqiraj– Kjo nuk i shërben as integritit, as qetësisë.

Ju lutem, qetësojuni dhe drejtojeni komisionin siç ju takon ta drejtoni!

Albana Vokshi - Fjalën e ka zonja Tomço.

Vilma Tomço- Përshëndetje!

Ndjesë për këto debate, sepse mbase jemi bërë molla e sherrit, por ne kemi zbatuar vetëm ligjin dhe rregullat e Autoritetit.

Siç e dini Autoriteti është krijuar dhe ka hyrë në funksionim gjatë vitit të kaluar si një bashkim i dy agjencive të Certifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike. Gjatë një periudhe gjashtëmujore ne kemi punuar për të rregulluar kuadrin ligjor të funksionimit të këtij autoriteti.

Gjithashtu, ishte në gjendje edhe një portal, i cili shërbente për të bllokuar faqet e paligjshme, i cili tashmë nuk është në gjendje pune. Kjo do të thotë se ajo që kemi bërë së fundi është përcaktimi i të gjitha infrastrukturave kritike të vendit, sepse ky autoritet funksionon edhe si *cirt* kombëtar dhe qeveritar dhe jemi duke ngritur të gjitha *cirtet* e tjera sektoriale në të gjitha institucionet publike dhe private.

Pra, është detyra jonë të ngremë strukturat për mbrojtjen e sigurisë kibernetike, si një nga elementet kryesore të sigurisë së një vendi. Jemi duke ngritur rrjetin e koordinimit midis autoritetit tonë dhe të gjitha strukturave të tjera të *cirteve* sektoriale dhe kemi për detyrë të monitorojmë dhe të auditojmë sistemet, nivelet e mbrojtjes dhe funksionimet e këtyre.

Në datën 24 ne vumë re funksionimin e një faqeje interneti. Ju lutem, kush është teknik këtu duhet ta kuptojë që nuk ishte portal, ishte një faqe e kopjuar, por që përdorte dy elemente, të cilat shkaktonin problem te ne: së pari, ishte simboli i Republikës së Shqipërisë dhe, së dyti, ishte përdorimi jo normal i një portali qeveritar nga e cila ekzistonte mundësia potenciale për një krim kibernetik. Duke qenë se tashmë ky është portali më i madh i alokuar pranë *datacenter*-it qeveritar, krijonte mundësinë *fishing* dhe shumë të elementeve të tjera.

Ajo që ne bëmë është se nuk e mbyllëm menjëherë, më vjen keq që flitet në këtë mënyrë, pasi ne u munduam të kontaktonim me administratorin e portalit. Faqja nuk kishte asnjë të dhënë tjetër veçse disa informacione që ne nuk hyjmë dhe nuk i shikojmë, sepse nuk janë në tagrin tonë për t'i vlerësuar. Pra, nuk kishim një administrator, një adresë e-mail-i, një pikë kontakti, një numër telefoni, nuk kishte asnjë informacion për të cilin ai mund të konsiderohej portal.

Në këto kushte, ne i kërkuam bashkëpunim AKEP-it të gjente mundësinë të kontaktonim me këtë faqe. Në pamundësi të kontaktimit, me qëllim që të ruajmë dhe të ndalojmë elementet ndërhyrës në infrastrukturën kritike të rëndësishme qeveritare, bëmë

bllokimin e pjesshëm të saj, gjë që do të thotë se portali nuk është tërësisht, ai ekziston, por ne bllokuam që qytetarët shqiptarë të mos ridirektoheshin dhe të merrnin informacion të gabuar. Portali me heqjen e këtyre dy elementeve është lehtësisht i aksesueshëm dhe i hapshëm, prandaj mjafton të na vihet në dispozicion pika e kontaktit, një numër telefoni, një administrator që të komunikojmë për të hequr dhe për të shmangur këto dy elemente, që ne i quajmë mundësi potenciale për ndërhyrje në sistemet kritike të vendit.

Albana Vokshi – Ne ju kemi dërguar një listë shumë të gjatë me pyetje, por ju keni refuzuar që të përgjigjeni.

I jeni përgjigjur vetëm njëërës prej pikave, pavarësisht se ne jemi munduar të ishim shterues, që ju të kuptonit atë çka ne kishim nevojë të kuptonim. Ju asnjërës prej pikave nuk i jeni përgjigjur dhe vazhdoni edhe sot të mos i përgjigjeni.

Vilma Tomço- Zonja kryetare...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Kur flas unë, ju lutem, mos ndërhyrni!

Ne jua dërguam pyetjet, që ju t’u përgjigjeshit. Ju refuzuat të përgjigjeshit, pavarësisht se e keni për detyrë të zbatoni të gjitha nenet e ligjit, nën juridiksionin e të cilit ju funksiononi.

Vilma Tomço- Në dijeninë time dhe në atë sa lexova, pyetjet referoheshin se kush na informoi dhe të tjera të këtij lloji. Unë ju përgjigjja, duke ju thënë se kemi një sistem dhe një qendër auditimi dhe monitorimi, pra, është e brendshme e agjencisë.

Albana Vokshi – Ne ju kemi kërkuar dokumentacionin. Çdo veprim i juaji mbahet shënim, regjistrohet, sepse ju jeni një institucion, atëherë më tepër ju nuk mund të veproni si në rrugë, pa letra, pa regjistruar çdo veprim tuajin. Ne këtë kërkuam, sepse duam të jemi të qartë nëse veprimi juaj është i drejtë apo nuk është i drejtë. Ju e keni për detyrë që të jepni informacionin, siç kemi kërkuar nga a-ja te zh-ja.

Fjalën e ka zoti Zela, me qëllim që të shterojmë pjesën e informimit.

Pastaj do të kalojmë te pyetjet.

Ilir Zela- Faleminderit, zonja kryetare!

Si ish - anëtar i këtij komisioni kohë më parë, i vlerësoj pa masë shqetësimet edhe pozicionin e secilit deputet të pranishëm.

Dua të sqaroj që mospjesëmarrja ime në ftesën e parë lidhet me arsye objektive dhe pikërisht me thelbin e shqetësimit të shprehur edhe nga zonja kryetare, çështjen e përgatitjes për fillimin e negociatave me Bashkimin Europian. Në ditën që duhej të isha këtu, kisha një takim me përfaqësues të Komisionit Europian lidhur me kapitullin X të negociatave. Për

informacion, dëshiroj t'ju vë në dijeni sa i takon këtij kapitulli, se Shqipëria, vlerësuar së fundi në raportin e komisionit, është në rrugë të mbarë dhe ka realizuar të gjitha angazhimet, si në kuadër të legjislacionit të fushës, po ashtu edhe në kuadër të përgatitjes së hapjes së negociatave dhe zbatimin e tyre.

Dua t'i sqaroj edhe diçka deputetit Baçi, i cili u ankua për arrogancë nga AKEP-i. Nuk ka pasur një qëllim të tillë nga AKEP-i, ne kemi dhënë përgjigje të plota, serioze dhe gjithë informacionin që duhet për t'iu përgjigjur pyetjes, pa asnjë lloj arrogance dhe tendence, gjë e cila jo vetëm që nuk na lejohet, pasi jemi institucion i pavarur, por as mua personalisht si njeri, me një histori të gjatë të shërbimit publik në Republikën e Shqipërisë. Në qoftë se ka diçka konkrete në përgjigjet tona, që lënë përshtypjen e arrogancës, i marr mbrapsht ato përgjigje dhe jua risjell edhe një here, duke hequr këtë element që mund t'ju ketë shqetësuar!

Albana Vokshi - Ju lutem, zoti Zela, futuni në temë, se nuk kemi kohë!

Ilir Zela - Lidhur me brendinë, siç ju thashë, kemi zbatuar vetëm ligjin. Këtë gjë e bëjmë në mënyrë sistematike dhe, nëse i shërben informacionit tuaj, faqja për të cilën është kufizuar aksesit është në *dotcom*, që nuk është një domen që administrohet nga Shqipëria. Nëse një faqe e tillë do të ishte në domen-in *al*, kjo nuk do të mund të alokohej që në fillim, siç nuk mund të alokohen faqe të tjera me emra institucionesh dhe as faqe të cilat janë me emra personalitetesh apo individësh. Për këtë ka rregulla të detajuara, të paktën për fushën *.al*. Edhe për këto që janë nën domen-in *dotcom*, ka rregulla dhe në qoftë se kërkon *"White House.com"* do të shikoni që nuk ka kontent që merret me gjëra të ndryshme nga qëllimi i këtyre emrave të njohur.

Lidhur me shpejtësinë e veprimtarive të AKEP-it, është detyra jonë të jemi sa më eficientë në realizimin e kërkesave të ligjit, ndaj jo vetëm në këtë rast, por edhe në raste të tjera, kemi vepruar dhe veprojmë shpejt, pasi është detyra jonë ta rrisim këtë shpejtësi. Rastet e fundit të kufizimeve të aksesit përfshijnë disa raste abuzive me të drejtat e kontentit të operatorëve të licencuar në Shqipëri dhe rastet që kanë të bëjnë me lojërat e fatit, me abuzimet, por në çdo rast vendimi për këto veprime është jashtë AKEP-it dhe ai thjesht i mbështet vendimet që merren nga institucionet ligjore, të cilat kanë tagrin përkatës.

E fundit, nëse ka dyshim për një veprim të paligjshëm të AKEP-it, jemi të gatshëm të mirëpresim shqetësimet dhe komentet tuaja për ta përmirësuar praktikën tonë dhe, sigurisht, çdo vendim apo akt që AKEP-i nxjerr, është i rishikueshëm gjyqësisht dhe po ju bëj me dije që deri më tani ne nuk kemi pasur ndonjë veprim gjyqësor ndaj aktiviteteve të AKEP-it në këtë fushë.

Jam i hapur për çdo pyetje që mund të kenë zonjat dhe zotërinjtë!

Albana Vokshi -Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Boçi.

Luçiano Boçi – Faleminderit, zonja kryetare!

Po flasim për një problem themelor, për çështjen e mënyrës së funksionimit dhe menaxhimit të medias *online*, që është një nga llojet e mediave alternative, e cila gjithnjë e më tepër po merr vëmendjen e publikut shqiptar dhe mbylljen e faqes *online*, jo thjesht portal, është edhe faqe edhe portal, termat nuk janë të përcaktuara ende në legjislacionin shqiptar. E konsideroj si një provokim të Kryeministrit, sikurse ka pasur edhe provokime të tjera të tij. Jo më larg se para dy ditësh, ky Kryeministër ka urdhëruar dekorimin e plagosësit të heroit të demokracisë, atij që në parlamentin shqiptar plagosi Azem Hajdarin. Është krejtësisht një akt i papranueshëm, sikurse në vazhdimësi shumë akte të tjera.

Do të më falni që u përqendrova te kjo pikë, por gjykoj që është shumë sensitive dhe reagimet e publikut janë të tilla, sikurse reagimi ynë i politikës duhet të jetë i fortë. Nuk kemi vetëm fazën e provokimit, të mënyrës se si i ka ndërtuar marrëdhëniet ky kryeministër me median, publikun dhe opozitën, i cili vazhdon jo vetëm të provokojë, por edhe të veprojë. Dekorimi, goditja e medias dhe blerja e tyre janë akte të kryera tashmë, me ndryshimet ligjore që propozohen, sikurse edhe tallja apo sorollatja e publikut nëpërmjet takimeve “klounë”, që organizon ky kryeministër.

Bashkë me kolegët e mi, para dy ditësh ishim në një konferencë për lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias në Bashkimin Europian dhe vendet joanëtare. Midis të tjerave, parashtruam çështjen e mbylljes së portalit “kryeministri.com”, në mënyrë nominative për këtë çështje. E dini se cilat ishin reagimet e europarlamentarëve të pranishëm dhe të zonjës Spineli, që drejtonte panelin? Në mënyrë absolute e kundërshtuan, madje...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, Milva, e kundërshtuan! Të vërtetën po them edhe unë!

Zonja Spineli ishte drejtuesja dhe u shpreh që ndërhyrje të tilla absurde në një ligj konsensual, siç është ligji i mediave, janë të papranueshme. Nuk mund të ketë mbyllje të portaleve *on-line*. Meqenëse po flas në mënyrë konkrete, ishte Silvia Grundmann, e cila u shpreh shumë qartë se është e pabesueshme që një portal *on-line* të mbyllet për arsye se ka përmbajtje satirike, sikurse edhe pjesëtarët e tjerë të panelit artikuluan dhe mbajtën të njëjtën linjë qëndrimi, madje u pa e habitshme se si Agjencia e Krimit Kibernetik barazon satirizimin me krimin kibernetik. Ishte e çuditshme në këtë rast!

Po përmend edhe shqetësimin e zotit Dezir, i cili iu referua edhe përplasjeve që ka pasur Kryeministri i Shqipërisë me gazetarët dhe cilësimeve që u ka bërë në vazhdimësi, duke i quajtur “hiena dhe prostituta”, madje mund t’i marrim e t’i zbardhim fjalimet e tyre në komisionin tonë. Kjo është më se e saktë dhe e vërtetë!

Për mënyrën si keni vepruar duke u mbështetur në atë që thatë, iu shmangët të gjitha pyetjeve që kemi bërë, iu shmangët edhe përgjegjësisë suaj, sikurse thatë gjëra që nuk qëndrojnë. Si argument kryesor, thatë që portali në fjalë ka rrëmbyer logon e Republikës së Shqipërisë. Zonja Tomço, ka një diferencë shumë të madhe midis logos së Kryeministrit dhe logos që përdoret për Republikën e Shqipërisë. Nuk janë të njëjta këto logo apo jo, është logoja që përdor Kuvendi, nuk e kemi këtu, kurse logoja e Kryeministrit është një logo që ndryshohet nga çdo kryeministër një herë në 4 vjet, madje ndryshohet edhe në mes të vitit, në qoftë se e gjykon kryeministri për ta ndryshuar.

Pra, ligji që ju i jeni referuar nuk ka të bëjë fare me logon e Kryeministrit, nuk është kjo logoja e Republikës së Shqipërisë, mos u ngatërroni me ligjin, se nuk është kjo! Ju e dini shumë mirë se stema është krejtësisht e ndryshme, është stema që përdor parlamenti i Republikës së Shqipërisë dhe janë krejtësisht të ndryshme, kështu që argumenti juaj bie.

Ju pretendoni se ka pasur *fishing* dhe për këtë arsye ju e keni mbyllur këtë faqe, pasi jeni lajmëruar. Unë nuk e di se ku dhe si, nga kush dhe si jeni lajmëruar, sepse minimalisht ju duhet të keni një raport konkret teknik të atakimit të kësaj faqeje për të bërë *fishing* për marrje të dhënash. *Fishing*-u për publikun është maskim për të rrëmbyer të dhënat sensitive, *password*-e bankash, karta krediti e të tjera. A e dini ku qëndron fakti, i cili është edhe qesharak? Ju pretendoni se këto të dhëna janë marrë nga portali “Shqipëria që duam”, apo jo? Unë e di se te portali “Shqipëria që duam” nuk blihet gjë me para dhe ata që hyjnë në portal për të bërë ankesat e tyre, përdorin një fjalëkalim të thjeshtë, një *password*, sepse nuk duan të identifikohen dhe mund të veprojnë në mënyrë anonime. Pra, nuk i hedhin të dhënat e tyre, gjë që është me dëshirë dhe jo me detyrim, në rastin kur ata marrin përsipër të denoncojnë veprimtarinë e administratës dhe kjo është mëse e saktë dhe e vërtetë. Pra, me qenë se ju po kundërshtoni dhe thoni se ka pasur *fishing*...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem, ta mbaroj fjalën!

Kjo është procedura...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk ndërhyjni dot, zonjë apo zonjushë, kur t’jua jap unë fjalën, vetëm atëherë mund të flisni.

Luçiano Boçi – Pra, meqenëse ju thoni se ka *Fishing* dhe e keni bllokuar nëpërmjet AKEP-it pikërisht aksesin e faqes në Shqipëri, ndërkohë që ju vetë thoni se aksesin i faqes bëhet jashtë Shqipërisë, po ju pyes: ku bëhet *fishing*-u më mirë brenda apo jashtë Shqipërisë? Si mundet një person që nuk banon në Shqipëri të bëjë *fishing* te faqja juaj e famshme e Kryeministrit, meqenëse janë të ngjashme, ndërsa një person që jeton në Shqipëri, po ju them se Shqipëria nuk e ka standardin e lartë të krimit kibernetik, mund ta bëjë dhe ju qenkeni të alarmuar! Ju jeni në kundërsjes logjik, sepse nuk është e kuptueshme për publikun që *fishing*-u realizohet përtej Shqipërisë dhe nuk bëhet ndonjëherë në Shqipëri. Plus kësaj mund të bëhet me fshehje ose me VPN, siç thoni ju, është i aksesueshëm, me fshehje IP-je, sepse këto janë masat që ju keni në dorë.

Në të gjitha argumentet që ju keni parashtruar, jeni alogjikë me mënyrën se si i paraqitët sot, ndërsa në mënyrën se si i keni parashkruar ju them se keni kërkuar një mbështetje ligjore që në fakt në terma të drejtë ekziston, por nuk mund të aplikohet, sepse sipas jush nuk e keni në aktivitet të plotë portalin unik *online*. Në fakt, unë portalin e kam hapur ditën që do të bëhej dëgjesa me zotin Zela, i cili nuk ishte i pranishëm dhe në portal ishte një listë e gjatë: NATO, *black* listë me 56 adresa IP-je që sot nuk hapen, sepse e kam përmendur dhe fjala ime është e regjistruar aty, ndërsa ju e keni bërë inaktiv këtë faqe.

Sipas kësaj faqeje dhe vendimit të Këshillit të Ministrave, që krijon pikërisht autoritetin tuaj, ju keni të drejtë të ndërmerrni iniciativën për bllokimin e faqeve në bazë të kërkesës së autoriteteve publike, kur përmbajtjet e tyre janë të paligjshme. Shqetësimi im kryesor është që duke shmangur një ligj të rëndësishëm për mediet *online*, ju keni ndërtuar një skemë ligjore fare të thjeshtë, në bazë të së cilës çdo autoritet publik në bazë të një ankimimi të tij në autoritetin tuaj, mund të mbyllë çfarëdolloj faqeje që ai e konsideron me përmbajtje të paligjshme. VKM-ja e përcakton qartë se është Autoriteti Publik ai që përcakton qartë përmbajtjen e paligjshme të faqes, apo jo? Në bazë të rregullores së famshme nr. 47, e cila është hartuar disa muaj pasi është bërë VKM-ja, janë rakorduar mirë me njëra-tjetrën: Autoriteti i Komunikimeve merr përsipër të bllokojë aksesin ose mbylljen e faqes. Pra, nuk jemi në fazën kur kemi krim kibernetik nga faqja në fjalë, sepse nuk kemi raport të *fishing* dhe nuk e keni parandaluar *fishingu*-n, sepse ai mund të realizohet, sipas jush është *.com*, edhe jashtë Shqipërisë, pra jeni krejtësisht jashtë funksionit.

Ndërkohë, ju jeni jashtë autoritetit tuaj, sepse në fjalën tuaj thoni se faqja, ajo që ju keni të drejtë të bëni nëpërmjet bllokimit të faqeve të ndryshme, nuk funksionon. Si mund ta merrni ju përsipër dhe të thoni se faqja nuk funksionon? Pra, meqë faqja nuk funksionon, ne marrim përsipër t'i bëjmë një kërkesë AKEP-it. AKEP-i e ka bërë me rregullore, kjo është e vërtetë, por te Rregullorja nr. 47, zoti Zela, e kam parë me vëmendje rregulloren dhe aty ka një mospërputhje mes qëllimit që ajo ka në vetvete dhe ndërmjet pikave që kanë të bëjnë me menaxhimin e këtyre faqeve të paligjshme. Për më tepër, ju duhet të konstatooni, sepse nuk jeni në veprimtari robotike, që sapo të merrni një lajm, duhet të veproni menjëherë, por duhet të konstatooni se cilat janë përmbajtjet e paligjshme.

Drejtuesi i autoritetit duhet ta dijë shumë mirë që ka një rregullore, e cila ka ekzistuar për faqen *online* dhe është në fuqi sipas ligjeve të shtetit shqiptar, të cilën duhej ta kishit referuar dhe ku përcaktohet qartë se cilat janë përmbajtjet e paligjshme: homofobia, thirrjet raciste, fyerjet, sharjet dhe cilat janë më pas autoritetet publike që vendosin. Në rastin e satirës ne nuk kemi përmbajtje të paligjshme, ndërsa ju justifikoheni që ka përmbajtje të paligjshme në përgjigjen tuaj, të cilën sot e ndryshuat në referimin tuaj. Për të provuar si veproni ju, sepse në mes është cenimi i një autoriteti dhe i figurës së tij në bazë të indiceve që nuk qëndrojnë, sepse edhe Endri që është specialist i fushës e tha shumë qartë se përderisa në faqe është direkt Kryeministri i rilindur, këtu bie edhe pjesa e justifikimit të logos, sepse logoja shoqërohet edhe me emërtim. Çdo njeri që di të lexojë, e di shumë mirë që kjo nuk është faqja e Kryeministrit, apo jo, është satirë dhe këtu kuptohet që nuk ka asnjë lloj kushti që ju të ndërhyni për ta konsideruar vjedhje të logos.

Pra, duke respektuar anën ligjore... A e dini se cila është ana ligjore? Ana ligjore, të cilën jua theksova, është VKM-ja nr. 141 e tetorit, duke respektuar edhe mënyrën e menaxhimit të faqes suaj *online* dhe mënyrën se si e ndërtoni komunikimin me AKEP-in, kam parë edhe ligjin nr. 49/2012, në mos gaboj, i cili përcakton se cilat janë autoritetet publike. Kjo është shumë rëndësishme. Autoritet Publik është çdo ent shtetëror, edhe i ushtrisë, edhe i policisë, por janë edhe personat, individët e zgjedhur që ushtrojnë kontroll. Pra, unë jam autoritet publik, çdo deputet është autoritet publik dhe në këtë cilësi të ligjit që ju keni hartuar, mbrëmë kam bërë një kërkesë fare të thjeshtë, këtë të drejtë ma jep ligji juaj, nuk është filozofia ime dhe këtu kam plotësisht të drejtë. Pra, unë si autoritet publik te faqja juaj, ju kam dërguar një *e-mail*, duke konstatuar që televizioni ERTV, që është në faqen e Facebook-ut të Kryeministrit, ka përmbajtje të paligjshme. Pse? Po jua argumentoj: ka sharje, fyerje, denigrim, madje tallje, ka satirë aty brenda dhe duhet ta mbyllësh, sepse po e mbylle atë për satirë, do ta mbyllësh edhe

këtë për satirë. Pra, për këto arsye shumë të thjeshta kam kërkuar dhe po e kërkoj publikisht mbylljen e faqes së ERTV-së. Çfarë do të ndodhë? Do të mbyllë aksesin e *facebook*-ut në Shqipëri? Kështu i bie.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, të mbaroj! Më pas do të japësh argumentet.

Kjo është kërkesa, e kam dërguar me *e-mail*. Ju mund të veproni shumë shpejt sot. Brenda 24 orëve mund t'ia dërgoni zotit Zela dhe ai e mbyll menjëherë aksesimin e këtij televizioni brenda territorit të Shqipërisë sipas kësaj përmbajtjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë!

Atë e mbyllte ai.

Prit, sepse këtu është e gjitha!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në bazë të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, nuk është rast tjetër.

Në bazë të kërkesës sime, meqenëse ju thoni se është rast tjetër...

Albana Vokshi – Përhapen *fake news*.

Luçiano Boçi – Po, lajme të pavërteta.

Albana Vokshi – Të gjitha janë të pavërteta.

Luçiano Boçi – Nëse doni ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Janë *fake news* të gjitha.

Luçiano Boçi – Nëse ju doni fakt konkret, unë këtu ose në portal ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Edhe një herë, Milva, të mbaroj!

Unë mund të kërkoj mbylljen e një portali *online*, por nuk është në filozofinë time si deputet. Mund të kërkoj mbylljen e portalit të Erion Braçes ose të Saimir Tahirit, që paguajnë dhe i menaxhojnë, pasi kanë sharë, kanë denigruar, çfarë nuk kanë bërë, por e respektoj median e lirë edhe në këto raste dhe nuk e bëj. Pra, nëse unë do të bëja një kërkesë të tillë... Jo me kot thashë për ERTV-në, që t'u shpëtoj këtyre paragjykimeve. Sot ju duhet t'i thoni menjëherë zotit Zela “mbylle”, sepse autoriteti publik, që është deputeti, ka dërguar këtë kërkesë me argumente,

sepse ka sharje pafund, ka denigrime pafund. Këtë mund ta bëjë jo vetëm Luçiano, por çdo deputet i Republikës së Shqipërisë.

E merrni me mend çfarë ligji keni hartuar ju dhe çfarë alarmi duhet të kenë mediet *online* dhe mediet në përgjithësi në Shqipëri? Ju, me një të lëvizur të gishtit të vogël të dorës mbyllni çdo portal me kërkesë të një individi, të një deputeti. E ka ligji që keni bërë ju, është procedurë ligjore. E keni shmangur ligjin për tregtinë elektronike, sepse nuk ka ligj për mediet *online*. Mos luani me termat “faqe *online*” dhe “portal”, sepse janë e njëjta gjë në terminologjinë gjuhësore ligjore shqiptare, nuk janë të ndryshme. Ne e mbrojmë faktin që është medie *online*.

Nëse unë i kthehem argumentit, sepse isha parapërgatitur që do të kishte kundërshtime të tipit “nuk është e njëjta gjë”, është e njëjta gjë, sepse e krahasoj me *Kryeministri.com*, zoti Zela tha se nuk është i regjistruar këtu si *domain*, por është jashtë Shqipërisë. Të drejtat që ka AKEP-i për të vepruar me faqet që janë në Shqipëri rregullohen me ligjet e Bashkimit Europian. Zoti Zela nuk mund të ndërhyjë në *facebook* në mënyrë absolute, e di shumë mirë këtë gjë. Nuk mund të ndërhyjë te një faqe që nuk është e regjistruar në Shqipëri, sepse nuk ka autoritet. Autoritetin për ta bllokuar aksesin e saj e ka vetëm në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fare.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ju lutem, zoti Luçi!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Milva, të lutem!

Në Shqipëri nuk ka ligj ku portalet ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Në Shqipëri nuk ka ligj që detyron faqet *online* të kenë një adresë. Ligji u parapërgatit për mediet elektronike, për tregtinë elektronike dhe nuk u avancua. Ai ligj e parashikonte, por sot aktualisht asnjë portal nuk ka detyrim të tregojë adresën, nëse është brenda apo jashtë Shqipërisë. Sipas modeleve të caktuara, kjo ekziston edhe në vendet e zhvilluara të Bashkimit Europian. Disa portale e kanë adresën e saktë, disa portale nuk e kanë. Disa portale kanë të drejtë të regjistrohen në “parajsat” e internetit, në raport me parajsat e famshme ku ju keni çuar të gjitha gjërat. Pra, jemi në kushtet që kemi shkelur jo vetëm ligjin ekzistues, por edhe rregulloret që kanë bërë të mundur funksionimin e kësaj faqeje që ne kemi kundërshtuar. Kemi pasur një debat shumë të gjerë me ish-ministren, zonjën Harito.

Unë do të doja që ju të sqaronit pse vepruat dhe cili ishte autoriteti publik që ju shtyu të merrnit vendimin. Ju thoni ka *phishing*. Nuk ka *phishing*, sepse nuk ka marrje të dhënash, nuk ka karta identiteti, nuk ka asnjë të dhënë sensitive te portali. Përderisa kjo bëhet edhe jashtë territorit, nuk keni marrë asnjë masë, keni marrë thjesht masën e bllokimit të informacionit. E dini ku është e vërteta? E vërteta është pikërisht te printimi. E bëtë sepse kishte katër postime rresht: thirrje e hapur për kandidimin si ministër i punëve të pista; thirrje e hapur si i afërm i ministrit; thirrje e hapur si kapiten mjetesësh lundruese, skafist i nivelit të parë; thirrje e hapur për kandidim si agronom kryeministrit. Pra, është marrë në mënyrë politike, sepse kjo faqe ka denoncuar në formën e saj satirike pikërisht atë që ne kemi thënë në formën akuzuese, të bashkëpunimit të kësaj qeverisjeje me krimin, të bashkëpunimit dhe daljes së aferave të dy ministrave përkatës të brendshëm. Kjo është situata dhe për këtë arsye ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Çdo ministër me një faqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Keni kryebashkiakun me faqe.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Milva, mos ndërhy!

Albana Vokshi – Kush ju lejon ju të censuroni kështu?

Ngadalë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi - Ju jeni institucion në varësi të Kryeministrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po flasim në zbatim të ligjit, jo si i bëni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Si mund të merrni ju urdhra në varësi të Kryeministrit direkt për interesa personale dhe t’ia dërgoni AKEP-it? Në këtë histori AKEP-i duket sikur i ka duart jashtë, por me mënyrën si është hartuar VKM-ja, si është hartuar rregullorja 47, i ka duart brenda, sepse duhet të konstatonte edhe arsyen e bllokimit të faqes, ndonëse mund të thotë se kuadri ligjor ekzistues e detyron të marrë masën e duhur në mënyrë automatike. Meqenëse e detyron, në bazë të kërkesës sime si autoritet publik, në bazë të aprovimit, që besoj se do të jetë shumë i shpejtë nga autoriteti i krimit kibernetik, ua përcjell juve kërkesën për mbylljen e televizionit të ERTV-së.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Për procedurë, një minutë, Milva.

Më pas e ka fjalën zoti Romeo dhe Endri.

Milva Ekonomi – Ne ishim në Pragë me një grup deputetësh. Në delegacion ishte zoti Boçi, zoti Ulqini, zonja Malaj dhe unë. Dua t'ju them diçka të vogël për Pragën. Në Pragë, midis folësve të ndryshëm, në një seminar me titullin “Pronësia mbi medien, transparencën dhe rregullimet standarde” ishte edhe një folëse, Silvia Grutman, shefe e Departamentit të Medies dhe Internetit në Këshillin e Europës, e cila bëri një prezantim për pluralizmin karshi lirisë.

Unë i bëra një pyetje dhe i tregova rastin e mbylljes së një portali: në Shqipëri ka 650 portale. Kemi mbyllur një portal satirik, i cili nuk ka pronar, ka vetëm *domain.com*, përdor logon e Kryeministrit dhe *switch-in emailed.net* të një portali të Kryeministrit. Si veprohet në një rast të tillë? Zonja Silvia u përgjigj: Në një rast të tillë, gjëja e parë që do të ndodhte në vendet anëtare të Këshillit të Europës ishte ta hidhnin në gjyq atë “njeri”.

E dyta, ky është rast i standardeve etike, mungon etika dhe tregon se njohuria në fushën e informatikës është e ulët. Kjo ishte përgjigjja që ajo na dha.

Diskutuam edhe për *fake news*, por zoti Boçi nuk ishte në atë moment. Ndërkohë, është diçka e rëndësishme, që ta kuptojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është shumë e rëndësishme për ta kuptuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Pse nuk e keni parë emrin?

Milva Ekonomi – Mund të kesh qenë në një takim aty jashtë, nuk them gjë, por në momentin kur u diskutua *fake news*-i, se *fake news*-i është një gjë e ndryshme nga lajmet qeveritare, ky ishte definicioni që na u dha atje.

Prandaj, do t'ju lutesha shumë, informacionet që marrim nga konferencat duhet të kenë një lloj integritetit kur të sillen këtu, sepse, po ta shikoni, zonja Gruman e ka vënë në prezantimin e saj *online* dhe një nga diskutimet e rëndësishme është *opnes versus freedom*. Në Shqipëri kjo është një gjë shumë e rëndësishme, se sa të hapur jemi, sa pluralizëm kemi në raport me lirinë. Kjo është analiza që duhet të bëjmë. Kjo ishte gjëja që na u tha atje.

Unë këtë lloj shqetësimi që kishte komisioni, e ngrita më pas dhe ishim të gjithë bashkë kur morëm këtë përgjigje. Me kë do ta bëjmë gjyqin? Cilin emër do të çojmë në gjyq?

Nora Malaj – Varet se cili institucion e ka bërë kërkesën...

Luçiano Boçi – Nora, vetëm një përgjigje për kundërshti...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Të lutem, se e kam listën shumë të gjatë! Do të ta jap fjalën.

Luçiano, 30 sekonda, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luçiano Boçi – Isha prezent edhe kur u fol për *fake news*-in. Çështjen e portalit, për korrektësi, si shqetësim e kam ngritur unë, pasi ju bëtë pyetjen, për ta plotësuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Milva, çfarë paskeni sot? Jeni e qetë zakonisht. Pse qenkeni shqetësuar? Ju paska dhënë dru Kryeministri në mëngjes?

Aman tani, të lutem!

Milva Ekonomi – Unë jam shumë e qetë, zemër.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, tani! Pyetjen e ngrita unë atje.

Albana Vokshi – Kjo nuk ka kuptim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

(Diskutime pa mikrofon.)

Luçiano, të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kërkoi për replikë fjalën.

Luçiano Boçi – Në vazhdimësi të zonjës Gruman, ishte parlamenti çek, i cili kishte punuar në një televizion çek satirik dhe ishte marrë personalisht me një program kundër Kryeministrit, që sot zotëron një nga mediet më të mëdha çeke dhe nuk e kishte gjetur asnjë gjë. Ai shprehu habinë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Është emision satirik, portal satirik.

Albana Vokshi – Luçiano, të lutem, mos e nis nga e para, se nuk na intereson fare kjo që thotë Milva!

Luçiano Boçi – Dhe reagimi ishte i tillë. Reagimi i tyre ishte kundër mbylljes së një medieje satirike *online*. Është e pabesueshme! Absurde!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Çfarë ke, Bujar?

Po, Romeo, të lutem!

Ju lutem, përmblihdhini pak diskutimet, që t'ia kalojmë më pas edhe të ftuarve fjalën.

Romeo Gurakuqi - Patjetër.

Në radhë të parë dua të falënderoj zonjën drejtore të Përgjithshme dhe zotin kryetar të AKEP-it për shpjegimet e shkurtëra!

Dua t'ju garantoj se praktikisht këtu kam ardhur për të mbrojtur interesat publike. Dua t'ju përcjell juve dhe gjithë kolegëve të mi rastin e shoqërisë sonë. Është një shoqëria e gjunjëzuar nga frika e njerëzve të forcës me telekomandë në dorë dhe me pushtet policor dhe kryeministrior urdhërues, që urdhërojnë deri edhe dekorimin e vrasësve të ish-deputetëve dhe ish-kolegëve tuaj, zoti Zela.

Jemi këtu për të mbrojtur interesat publike dhe dua t'ju vë në dukje që viti 2018 ka qenë një vit ku hapësira publike është ndotur, para së gjithash, nga kontrolli i krimit të organizuar të shoqërisë, gjë që ia kam thënë drejtpërdrejt ministrit të Punëve të Brendshme, nga gjunjëzimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, i Policisë së Shtetit, para bandave.

Shoqëria gjendet para flirtimit të hapur të deputetëve të maxhorancës, të ministrave, të kryetarëve të bashkive, me gjobëvënësit e rëndomtë qendrorë dhe lokalë, për qëllime të përdorimit elektoral, si dhe nga vendosja e interesit të disa grupeve financiare dhe sipërmarrëse të lidhur me Kryeministrin e vendit para interesit publik.

Unë kam disa pyetje që ju adresohen juve, por kam edhe pyetje që u adresohen edhe deputetëve të maxhorancës, për të cilët unë kam vlerësim, se ka të paktën një vit që jemi këtu bashkërisht dhe është shumë e rëndësishme që ata, si qytetarë të këtij vendi, si deputetë të këtij Kuvendi, të mos mbahen mend vetëm për qenien e tyre këtu si deputetë, por, para së gjithash, për kontributin e tyre para pastërtisë së sferës publike nga krimi, korrupsioni, kotësia, babëzia dhe hajdutëria.

Së pari, një pyetje e kam për ju, zonja Tomço. A jeni kontaktuar nga zyra e shtypit pranë Kryeministrit të vendit për rastin në fjalë? Çfarë lloj shkrese keni hartuar?

Së dyti, kur keni kryer veprimin tuaj, a keni pasur parasysh se keni cenuar nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, për të drejtën për të marrë informacion dhe ide të paanshme, pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa vendosur kufizime?

Pyetja tjetër ju adresohet jo vetëm juve, por edhe deputetëve të nderuar të Partisë Socialiste. Si shpjegohet që një sferë shumë e rëndësishme e paanshmërisë së shtetit, që përfshin institucionet tuaja, kontrollohet nga ish-deputetë të Partisë Socialiste dhe personazhe të maxhorancës aktuale, në një kohë kur ky institucion duhet të jetë totalisht i paanshëm, për të garantuar pikërisht nenin 10 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut?

Me këtë rast dua t'u drejtoj disa pyetje deputetëve të Partisë Socialiste, që lidhen me shqetësimet publike shumë të rëndësishme të sferës publike të interesave të elektoratit që unë përfaqësoj, të njerëzve të thjeshtë të këtij vendi.

Së pari, a keni kurajën ju, të nderuar deputetë të Partisë Socialiste, të ndërprisni mbështetjen ndaj ministrit të Brendshëm, i cili në muajin shtator të vitit 2017 premtoi para të gjithëve çmontimin e 40 bandave, të cilat kontrollojnë *underground* jetën totale të Tiranës dhe çdo qosh të këtij vendi? Në vend të këtij premtimi elektoral ne kemi marrë të kundërtën.

Së dyti, a mundeni ju, të nderuar kolegë, të ndalni babëzinë e shefit tuaj, që e ka marrë si e ka marrë me tagrin e qeverisjes, që të mos tjetërsojë pronat publike për interesat e një firme të vetme, që kontrollon edhe një institucion shumë të rëndësishëm të pavarur të drejtësisë?

Së treti, a i njihni ju tagrat politike dhe legislative, që jua kanë dhënë votuesit dhe se nuk jeni votues të robotizuar të vendimeve që merren në kupolë, por para së gjithash, jeni legjislatorë koshientë, që mund të rrëzoni çdo politikan, edhe të partisë suaj, kur qartazi operon me skema të çmendurisë, të babëzisë, të irracionalitetit dhe kur vendin e lë pa mbrojtje të rendit publik?

Së katërti, si mundeni ju, deputetë, është një pyetje që unë e bëj prej 10 muajsh, të pranoni në heshtje financimin e përditshëm të çdo rrugice, të kërkuar nga deputetë socialistë të Shqipërisë së Jugut dhe të lini gjithë Shqipërinë e Veriut pa asnjë financim, me një popullsi që çdo ditë ikën nga rrethimi i bandave, që mbledhin votat për socialistët dhe kanë kontrolluar varfërinë e këtij vendi?

Së pesti, si mundeni ju të pranoni çdo ditë heqjen nga puna të njerëzve të vobektë të këtij vendi, të njerëzve pa parti, të mësuesve dhe krijimin e një klientele të tërë politike që drejton sistemin arsimor të këtij vendi? Si mundeni ju të certifikoni procesin e konsolidimit të drejtorëve politikë në të gjithë sistemin arsimor të mesëm të këtij vendi?

E ndjej për detyrë, të nderuar kolegë, t'ju them se Shqipëria është në një kaos të përgjithshëm kushtetues për shkak të mungesës së një Gjykate Kushtetuese, e cila i lejon punonjësit e dy agjencive shumë të rëndësishme të operojnë pa pasur frikë se një institucion mbi ta mund t'i ndëshkojë për veprime të pabazuara në ligj. Është në një kaos institucional, një vend i fundosur në valët e urrejtjes dhe paradoksalisht autorët e kësaj sate pretendojnë që pas 10 ditësh, thotë zotëria, pasi e ka numëruar me shumë saktësi, do të hapin negociatat për anëtarësimin në BE. Si është e mundur që një popull kaq i vuajtur të ketë udhëheqës kaq të pashpirt dhe kaq aventurierë? Si e shpjegoni ju, të nderuar profesorë, që nuk reagoni bashkë me shoqërinë civile në mbrojtjen e Republikës së dëmtuar nga grabitësi?

Ju faleminderit!

Ismet Beqiraj – Ju lutem, ju ndërhyini sa herë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më vjen keq për kolegun tim profesor!

Romeo Gurakuqi – Ju siguroj që kjo që ju kam përçuar juve është pjesë e kërkesave të elektoratit dhe njerëzve të thjeshtë të këtij vendi dhe jo e interesave politike. Ju garantoj për këtë gjë.

Ismet Beqiraj – Të lutem, se ndaj je drejtuese, mos devijoj pyetjet! Po bën diskriminim veri-jug. Çfarë është kjo? Kjo është teza më kriminale, më tradhtare dhe më antishqiptare.

Romeo Gurakuqi – Është qasja e Kryeministrit tuaj dhe unë jua kam argumentuar me fakte të bazuara në statistikat e Ministrisë suaj të Financave dhe Institutit të Statistikave të këtij vendi, dhe mund t'iu referoheni kur të doni. Nëse unë kam gabuar sado pak, ju kërkoj falje, por ju garantoj se disproporcioni mes financimeve në Shqipërinë e veriut dhe në të gjitha zonat tuaja elektorale është i paimagjinueshëm.

Ismet Beqiraj – Mos rri si i persekutuar, profesor i nderuar!

Albana Vokshi – Ismet, prononcohu për dekorimin e Gafur Mazrekut si qytetar nderi!

Ismet Beqiraj – E dënoj.

Albana Vokshi - Si e dënon? Shprehu, pra, këtu dhe dënoje! Dënojeni të gjithë ju! Distancohuni nga ky akt i dhunshëm dhe provokues! Si mund ta nderoni vrasësin me urdhër të Kryeministrit? A e kuptoni se çfarë po bëni? Për këtë merre fjalën ti! Ku po e çoni këtë vend? Si mundeni ju të dekoroni vrasësin dhe të mos flasë askush?!

Ismet Beqiraj – Po të jetë antiligjor unë e dënoj, por çfarë është kjo tezë jug-veri? Nuk mund ta pranoj që një kolegu im profesor të fusë frymën e ndasisë kombëtare.

Albana Vokshi – Ju po mbron kriminelët, po mbron vrasësit, po mbron trafikantët dhe u jepni titullin “Qytetar nderi”!

Musa, do të flasësh apo jo?

Prononcohuni se ky është modeli që ka sjellë Edi Rama, i cili mbron kriminelët, vrasësit, trafikantët dhe i nderon me urdhërin “Qytetar nderi”, siç po bën me këtë, që ka qëlluar me armë para dy dekadash tribunin e demokracisë, Azem Hajdarin. A e kuptoni se çfarë po bëni? Po e vrisni për herë të dytë dhe është turp.

Ismet Beqiraj – Kjo qeveri po i kap edhe në vrimën e miut, përditë po kapen. Kjo qeveri po denoncon krimin, drogën, po e nxjerr nga pallati i pushtetit krimin 27-vjeçar.

Albana Vokshi – Të gjithë ju duhet të distancoheni! Kush po e denoncon? Ju po e nderoni dhe po e mbron krimin. Për këtë filloni të flisni. Është turp që askush nuk guxon të flasë.

Ismet Beqiraj – Thoni një herë të paktën “Bravo që u kapën 613 kilogramë kokainë!”, “Bravo që po kapen mijëra tonë!”. Pse nuk e thoni, por e shani qeverinë nga mëngjesi në darkë?

Albana Vokshi – Kush e mbushi Shqipërinë me kanabis dhe kush po e mbush? Kush po i çon avionët lart e poshtë të mbushura me drogë?

Ismet Beqiraj – Denoncoi!

Albana Vokshi – Sigurisht, falë denoncimeve tona po i kapni dhe nuk po i kapni ju, por autoritetet e huaja.

Ismet Beqiraj – Mos hidh tezën jug-veri! Turp i Zotit! Është kriminale, është tezë antishqiptare. Këta duan ata që nuk na duan, që ne të hamë kokat me njeri-tjetrin. Ta dëgjoj këtë nga goja e një profesori, unë ligështohem.

Albana Vokshi – Në momentin që ministria nuk flet për Xhafajn dhe Tahirin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Mbylle Ismet, tani!

Musa Ulqini – E nderuar zonja kryetare, unë nuk kam pyetje, por shumë shkurt do të shpreh një opinion timin për çështjen që po diskutohet këtu, duke e ndarë në dy pjesë.

Çështja e parë është ajo për të cilën jemi thirrur në këtë mbledhje. Unë kam një falënderim për zonjën Tomço dhe zotin Zela, sepse shpjegimet e tyre ishin të ftohta, larg çdo lloj politizimi, ligjore, të qarta dhe të thjeshta. Nga këto që kam lexuar dhe nga shpjegimet që më janë dhënë kur kam pyetur, por edhe nga këto që dëgjova këtu, në mendimin tim, çështja për të cilën jemi mbledhur dhe për të cilën bëhet ky debat, i cili nuk ka lidhje me çështjen, nuk ka fare lidhje me lirinë e medias e as me lirinë e shprehjes, ka të bëjë me një problem tjetër, sigurinë kibernetike të vendit. Sot siguria kibernetike është një problem shumë i madh në botë. Në SHBA ka një debat të zjarrtë dhe po bëhet një hetim i paprecedent. Edhe kur ishim në Pragë, në seancën e pasdites, kjo çështje u cek nga folës të ndryshëm.

Ky është komenti im për çështjen në fjalë, sepse gjërat janë të qarta dhe të thjeshta, pra kemi dy gjëra të ndryshme, sepse këtu ngatërrohen. Kjo është një çështje shumë e qartë.

Unë kam vetëm një koment për të gjithë këtë tension politik, që shoqëron këtë çështje teknike. Mendoj se as pengimi i çeljes së negociatave më 28 qershor dhe as zgjedhjet elektorale nuk fitohen duke tensionuar dhe prishur seancat parlamentare dhe mbledhjet e komisioneve, se po të ishte kaq e thjeshtë, do t'i kishin provuar të tjerët përpara në Shqipëri apo në vende të

tjera. U bënë shumë pyetje, unë nuk kam pyetje për askënd, por kam vetëm një pyetje që është në mendjet e një pjese shumë të madhe të shqiptarëve. Unë nuk flas në emër të të gjithë popullit, por besoj se një pjesë e mirë e njerëzve, të politizuar ose jo, kanë në mendje këtë pyetje: Si ka mundësi që pas 28-30 vjetëve ata që kontribuan aq shumë për pluralizmin me parullën kryesore “E duam Shqipërinë si gjithë Europa” bëjnë ç’është e mundur, 24 orë në 24, që Shqipërisë të mos i çelen negociatat më 28 qershor?

Kjo është pyetja që kam për kolegët e mi dhe besoj se jam në sinkron me një pjesë të konsiderueshme të njerëzve.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Fjalën e ka zoti Hasa, pastaj zonja Malaj.

Do të të kujtoj edhe një herë, Musa, se çfarë ka thënë Komisioneri Hahn në Tiranë, sepse e ka bërë deklaratë publike. “Nuk ka hapje të negociatave për të gjitha vendet që nuk respektojnë lirinë e medias dhe të fjalës”. Kjo që ju po bëni është censurë dhe nëse ju mendoni se ne po e bëjmë thjesht për politikë, dua të të tregoj edhe rastin e 4 medieve në Azerbajxhan të bllokuara njësoj si Kryeministri.com nga presidenti në prill të vitit të shkuar, që tani janë në Gjykatën e Strasburgut. Cili është argumenti që janë në Gjykatën e Strasburgut? Bllokimi i tyre ishte joligjor, i paligjshëm dhe jo i proporcionuar. Pra, në të njëjtën mënyrë siç është mbyllur këtu, çështja ka shkuar në Gjykatën e Strasburgut dhe është pranuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva, a e kupton se çfarë po them, apo jo? I është referuar Gjykatës së Strasburgut, sepse ju nuk bëni dot censurë, është pjesë e censurës. Po shkelni nenin 22 të Kushtetutës, po shkelni disa nene të konventave ndërkombëtare. Çfarë ka për të mos kuptuar këtu?

Endri Hasa – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Këtu sot diskutohet dhe flitet, në radhë të parë, jo për çështje teknike, por thjesht dhe pastër për censurë. Nuk ka teknikalitet, zonja Tomço, dhe këtë jua them me shumë qartësi dhe përgjegjësi të plotë teknike dhe ligjore, që ju çon ju në bllokimin e diçkaje vetëm për përmbajtje, “nuk ka *fishing*, nuk ka këtë e atë”. Ato që na keni sjellë këtu janë thjesht broçkulla për të fshehur arsyen e vërtetë, për të fshehur autorin dhe për t’u fshehur pas teknikaliteteve të ndryshme.

Për t’iu rikthyer teknikaliteteve, ju nuk na sillni asnjë dokumentacion, që ua kërkon ligji për agjencinë tuaj, si, për shembull, raporti i incidentit, të dhënat për të identifikuar sistemin,

problematika që do të sillte procedura e zgjidhjes. Ku janë këto teknikalitete, meqenëse ju fshiheni pas tyre?

Teknikisht ju garantoj që jeni totalisht të bindur, por ju ka zënë halli i madh nga ai që keni mbi kokë, nga ai fajtori i madh që ka bërë të gjitha zullumet, nga Kryeministri, i cili ju ka detyruar. Nga ana tjetër, askush nuk e shpiku dhe e kërkoi këtë incidentin e madh pranë Alcirit. A i njoftuat *cirtet* partnere për këtë rrezikshmëri të lartë në cenim, sepse paska rrezikshmëri të lartë ky? Është qesharake. Si mund të thoni *fishing* për diçka që çon *e-mail* te një portal qeveritar? Ju paskeni pasur reklame qyl për një faqe qeveritare! Reklamë falas. Ku është cenimi? Nuk ka asnjë arsye teknike, nuk ka asnjë bazë ligjore, prandaj nuk e keni shkruar në letër, se po ta kishit, do ta kishit sjellë.

Sipas ligjit këto kundërmasa merren dhe u dërgohen operatorëve kur ka rrezikshmëri, kur ka cenim, kur ka efekt mbi sigurinë kibernetike të këtij vendi. Ku është siguria këtu? E vetmja gjë që rrezikohet këtu është qetësia mendore e Kryeministrit. U shqetësua Kryeministri nga satira dhe kjo satirë na sillka sot rrezik në sistemet elektronike qeveritare, sepse i vetmi problem që ka Edi Rama është mbyllja e çdo zëri të lirë, se fjala e lirë e mbyt qeverinë dhe përdoret çdo mënyrë për të zhdukur lajmin, për të prodhuar lajme të rreme, për të larguar mendjen e njerëzve nga faktet tronditëse, siç është rasti i vëllait të ministrit të Brendshëm, Agron Xhafaj, i cili është dënuar në Itali për trafik droge. Ai jo vetëm mbrohet nga dënimi, por i sigurohet liri dhe mbështetje e plotë që të vazhdonte i qetë aktivitetin e tij. U bë më shumë se një muaj dhe nuk është marrë nga prokuroria, asnjë distancim nga Edi Rama, por kemi vetëm mbrojtje të përditshme të krimit, trafikut, bandave të lidhura me qeverinë. Kjo është një situatë e paprecedent, skandaloze dhe dhunim i shtetit ligjor, sepse Saimir Tahiri u lirua, Nazer Seiti u degdis në Itali dhe Fatmir Xhafaj vazhdon të shkatërrojë provat, të shantazhojë dëshmitarët, të trysnojë gazetarët dhe të përndjekë opozitën, të dhunojë fjalën e lirë, të mbyllë çdo zë që qarkullon. Nuk ka asnjë gjë teknike këtu, por gjithçka është politike, gjithçka është në dorën e Edi Ramës. Ju e keni mbi kokë dhe i jeni përgjigjur.

Ju bëtë postierin për një kërkesë joligjore për të mbyllur gjithçka dhe e dërguat me postë, duke detyruar AKEP-in të bllokojë aksesin e një faqe që thotë: “Kryeministri i rilindur”. Çfarë e shqetësoi Kryeministrin? Kjo rilindja e tij? Kryeministrit t’i vijë turp, sepse ka marrë peng këtë vend dhe, si bixhozçi i mirë që është, ka vënë bast fatet e Shqipërisë me Europën, duke mbështetur krimin, sepse ai është arkitekti; ai vazhdon ta mbajë në krye të Ministrisë së Brendshme Fatmir Xhafajn; ai vazhdon ta thellojë çdo ditë kapjen e prokurorisë; të shtojë presionin ndaj drejtësisë. Edi Rama është arkitekti i censurës dhe dhunimit të medias, madje

është edhe arkitekti i blerjes së medias që po qarkullon së fundi. “Ta blejmë median me çdo mënyrë; t’i shpërndajmë fonde publike dhe, meqë nuk i menaxhon dot mirë, t’ua japim disa të tjerëve”. Ai censuron portalet dhe ju detyroheni të shkruani pallavra nëpër letra. Nuk keni asnjë bazë ligjore. Nuk ka asnjë kontent malinj. Nuk ka asnjë pikë kodi malinj në atë faqe për të cilën flitet këtu. Por çfarë ka?! Ka disa fjali që nuk i paskan pëlqyer Kryeministrit! Ashtu siç do ai t’i mbyllë fjalën çdo kujt që nuk i pëlqen, është kollaj, siç tha edhe Luçiano, hajde të kërkojmë të gjithë të mbyllim çdo gjë që nuk na pëlqen. Në qoftë se është për kontent, shkoni në gjykatë. Në qoftë se është cenim i sigurisë kibernetike, jam dakord të flasim për terma teknikë. Ju e dini shumë mirë, si teknike që jeni, se këtu nuk ka fare çështje teknike, por është frika dhe tmerri i Edi Ramës dhe varësia e pushtetit të tij nga cenimi i fjalës së lirë. Nuk do që njerëzit të dinë; nuk do të flasë askush, sepse ai i trembet fjalës. Ai i trembet fjalës, sepse do të mbrojtë trafikun, krimin; do të mbrojtë me çdo kusht Tahirin dhe Xhafajn e tij, të cilët kanabizuan gjithë këtë shtet.

Europa nuk mund të tolerojë një Kryeministër, i cili është i kapur dhe i shantazhuar nga droga. Ka kapur drejtësinë për të shpëtuar Tahirin, për të mbrojtur Xhafajn dhe për të shkatërruar hetimet. Prandaj kjo nuk është çështje teknike.

Për sa u përket çështjeve teknike, ne po presim këtu ende, sillni letrat që ju detyron ligji të mbani: raportin e incidentit, të dhënat e identifikuar nga sistemi dhe të gjitha gjërat e tjera. Mos u bëni qesharakë duke thënë se është publikuar një *e-mail* në një faqe, i cili do të cenojë rëndë sigurinë kibernetike të vendit, sepse kjo është skandaloze dhe e turpshme.

Albana Vokshi – Faleminderit!

Fjalën e ka Nora, pastaj profesori. A keni ju diskutime? Pas diskutimeve, a mund të prononcoheni për propozimin për dhënien e titullit “Qytetar nderi” Gafur Mazrekut?

Adelina Rista – Zotëria, që e ka këtë faqen, ku është?

Albana Vokshi – A keni ndonjë prononcim, apo jo? A do ta dënoni, apo jo?

Adelina Rista – Pse i është zënë zëri? Pse i është mbyllur zëri i lirë, sepse i është mbyllur faqja, i është prekur e drejta?! Ku është ky zotëria?

Albana Vokshi – Adelina, a ke ti ndonjë prononcim për nderimin e Gafur Mazrekut?

Adelina Rista – Ku është ky zotëria?

Albana Vokshi – Nuk mund të flitet për gjë tjetër sot, se ju po vrisni demokracinë. Me censurë po vrisni demokracinë...

Adelina Rista – Prandaj jemi ne këtu ta dëgjojmë, se i është hequr e drejta...

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Adelina, e ke ndonjë prononcim?

Adelina Rista – Ta dëgjojmë, se i është prekur e drejta...

Albana Vokshi – A ke ndonjë prononcim, e dashur, për nderimin e Gafur Mazrekut?

Për këtë fol. Adelina, ke apo nuk ke, apo nuk shpreheni ju pa ju dhënë urdhër?!

(Reagim pa mikrofon.)

Jo, kam unë, po të drejtoj pyetjen: a ke ndonjë prononcim ti, apo nuk keni marrë urdhër ende se për çfarë do të prononcoheni?

Adelina Rista – Më jep përgjigjen e pyetjes që të bëra një herë!

Albana Vokshi – A keni prononcim ju, sepse sot keni propozuar për të nderuar atë që dy dekada më parë, brenda aulës së parlamentit, ka goditur tribunin e demokracisë, Azem Hajdarin? Vetëm kjo çështje duhet të diskutohet sot, sepse kjo është çështja më e madhe, sepse ju po e vrisni për herë të dytë tribunin e demokracisë.

Milva Ekonomi – A mund të flasim edhe ne në emër të grupit diçka për këtë çështje, sepse edhe ne e kemi diskutuar dhe kemi një prononcim?

Albana Vokshi – Cila është e vërteta? A e ke lexuar propozimin, apo jo?

Fidel Ylli – Kush e ka bërë propozimin? Kryeministri e ka bërë propozimin?

Albana Vokshi – Kryeministri e ka urdhëruar dhe ju e dini shumë mirë, se nuk guxon askush në partinë tuaj të bëjë... Ka disa ditë që ka qarkulluar dhe bëni sikur nuk dini gjë...

Milva Ekonomi – Na lër ta shpjegojmë!

Albana Vokshi – Nuk e fshihni dot ju...

Milva Ekonomi – Na lër ta shpjegojmë. Ne të gjithë e dimë që pushteti qendror dhe pushteti vendor janë dy institucione të pavarura dhe në të gjitha institucionet tona të qeverisjes vendore ka këshilltarë. Kjo gjë është në Shqipëri. Ndërkohë, që ne po përpiqemi ta bëjmë këtë gjënë sa më mirë...

Albana Vokshi – Ja ku e ke!

Milva Ekonomi – Ja ku kam edhe unë këtë.

Albana Vokshi – Ja ku e ke shkresën...

Milva Ekonomi – A është shkresa e këshilltarëve?

Albana Vokshi – Ja ku e ke me firma dhe me vula, meqenëse nuk e dinit.

Milva Ekonomi – Po flas dhe më lër ta mbaroj!

Atëherë, Kryeministri Edi Rama është distancuar nga ky gjest dhe ka thënë: “Turp, Mazreku nuk duhej të ishte propozuar “Qytetar nderi” i Hasit dhe t’u vijë turp atyre këshilltarëve të Këshillit Bashkiak të Hasit...”

Albana Vokshi – Ja ku e ke kryetarin... Dënojeni ju dhe distancohuni, se ne e dimë shumë mirë.

(Reagim pa mikrofon.)

Ju nuk guxuat të flisnit derisa ju erdhi kjo, Milva, gëk-mëk, gëk-mëk, kur të gjithë e dimë që është Rama i cili jep urdhrat. Nuk guxon Lala atje të bëjë qoftë edhe një hap...

Milva Ekonomi – Do të më lësh të mbaroj?

Albana Vokshi – ...që të bëjë një propozim, pa marrë miratimin për një çështjeje të tillë...

Milva Ekonomi – Mos më ndërhy! Unë të lashë ta tregojë gjithçka që kishe. Mos më ndërhy, kur flas unë.

Albana Vokshi – Ja ku e ke, ja turpi! Ju ku e keni!

(Reagim pa mikrofon.)

Ju e dini shumë mirë që është bërë me urdhër të Ramës.

Milva Ekonomi – Moj Albana, moj Albana!

Albana Vokshi – Kërkojani ta tërheqë... Kërkojani ju këtu, bashkohuni me ne, që ky ta tërheqë propozimin. Ngrijeni zërin! Do t'ju bëj nder juve!

Milva Ekonomi – A mund të flas edhe unë? A mund t'ju them diçka? T'ju them që edhe sot gjatë mbledhjes, kur bëre këtë kërkesë, Ismeti të tha se ne e denoncojmë atë gjë. Është turp që kriminelë të tillë, njerëz të tillë, të marrin tituj nderi në një këshill bashkiak. E dëgjove nga Ismeti...

Albana Vokshi – Mirë, distancohuni dhe kërkojini Kryeministrit të mos bëjë provokime të tilla. Është provokim! Është provokim i Edi Ramës.

(Reagime pa mikrofon.)

Distancohuni, se është turp!

Milva Ekonomi – Moj, Albana, a e dëgjove?

Albana Vokshi – Nuk i provokoni dot ju as opozitën, as Kukësin, as qytetarët shqiptarë...

(Deputetët flasin njëzëri.)

Nuk shkelni dot ju mbi figurën e Azem Hajdarit! Është turp!

(Deputetët flasin njëzëri.)

Provokatorin po e bëni ju.

Ismet Beqiraj – Unë u distancova...

Albana Vokshi – Ja ku e keni me firmë të kryetarit!

(Deputetët flasin njëzëri.)

Ismet Beqiraj – Ajo po flet në emër të grupit të maxhorancës.

Milva Ekonomi – A mund ta mbaroj? Të lutem, Ismet! Më jepni rastin t’jua përsëris dhe, ju lutem shumë, mos më ndërprisni, se po bëhet kakofoni. Mos fol Ismet, të lutem!

Edi Rama është distancuar nga ky gjest duke thënë: “turp!”. Domethënë, kjo është një gjë për të cilën nuk e ka marrë vendimin Partia Socialiste... Është turp! Detyrimi i Këshillit Bashkiak të Hasit... Edhe pse ata janë socialistë, ne jemi distancuar nga ky gjest. OK-ej? Ta përsëris? Është thënë se është turp. Ndërkohë...

Luan Baçi – E kërkova fjalën. Sinqerisht, mua më vjen mirë që ka një distancim të hapur dhe zyrtar; më vjen mirë që në mbledhje të grupit Kryeministri ka deklaruar se është një turp i vërtetë. Sinqerisht për këtë...

Albana Vokshi – Ai e ka urdhëruar...

Luan Baçi – Ju lutem, të mbaroj deri në fund!

Albana Vokshi – E ka provokuar, po rri tani! E dini ju më mirë se ne...

Luan Baçi – Më lër të mbaroj! Sinqerisht, është mirë, por nuk kuptoj një gjë: si ka mundësi që anëtarët e këshillit bashkiak të Partisë Socialiste mund të veprojnë në këtë mënyrë, kur ka mbi 2 javë që përflitet se ka një shkresë, ka një kërkesë të tillë, ka një orvatje të tillë? Kjo është marrë vesh publikisht në rrjetet sociale, në medie dhe gjithandej. Nuk mund ta besojë askush, asnjëherë, sepse është e paimagjinueshme që të mos jetë marrë vesh dhe të mos jetë ndërhyrë nga qendra për t’ju thënë këshilltarëve të Partisë Socialiste: jo, ky veprim nuk duhet të kryhet.

Albana Vokshi – Në bllok të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Baçi - Kjo është t’u hedhësh hi syve dhe është e pafalshme.

Së dyti, po bëj edhe një shtesë tjetër, e zëmë se nuk është ndërhyrë, ka kaluar kjo punë. Është në tagrin tuaj, përveç këtij distancimi, që të mblidhni menjëherë këshillin bashkiak dhe ta anulojë këtë vendim. Vetëm atëherë mund të merret e mirëqenë deklarata e Kryeministrit, vetëm kur të anulohet vendimi i këshillit bashkiak, dhe ai anulohet me shumicë votash, dhe ai zotëri të mos shpallet “Qytetar nderi”, mund të jetë e besueshme, ndryshe kjo është t’u hedhësh hi syve.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ai shkarkoi ata në Kukës apo sepse ishin të pavarur. Çfarë po thoni?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Baçi – Zotëri, të mos tallemi: është më mirë të mos prononcoheni, sesa të distancoheni dhe të jetë fakt i kryer.

Musa, për herë të parë kërkoj njëfarë mirëkuptimi.

(Diskutime pa mikrofon.)

Të mbledhë këshillin bashkiak dhe të anulohet.

Albana Vokshi – Të lutem, Musa!

Luan Baçi – Absolutisht, kryetari i Partisë Socialiste mbledh grupin e këshilltarëve dhe e anulon, sepse ai është vendim politik.

Albana Vokshi – Së pari, mos veproni me dy standarde.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet, është bërë kërkesë, mbledhja e këshillit është të hënën...

(Diskutime pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Ne distancohemi nga ky veprim.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Fidel, kërkojini të tërhiqet.

Fidel Ylli – Patjetër.

Albana Vokshi – Sot kanë bërë propozim që mbledhja e këshillit të zhvillohet të hënën. Jo prefekti, është mbledhja e këshillit. Keni këshilltarët, tërhiqeni.

(Diskutime pa mikrofon.)

Në Kukës i shkarkuat këshilltarët pse morën pjesë në protestë, ndërsa tani thoni se është i pavarur!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet, kam dy këshilla për Edi Ramën, dëgjoji që t'ia përcillni.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – ...Ato janë vendimmarrje politike. Ju shumë faleminderit që na sugjeroni, por e kemi bërë. I pari e ka bërë Edi Rama.

Albana Vokshi – Dëgjo pak, tani.

Ismet Beqiraj – Ai nuk të dëgjon as ty, as të tjerët dhe as mua. Ai e bëri vetë i pari. Ai është koshient dhe i përgjegjshëm për një gabim...

Albana Vokshi – Dy këshilla, kaloja pak kryetarit tënd dhe Kryeministrit të shqiptarëve.

Së pari, ta tërheqë, sepse ka kohë deri të hënën.

Ismet Beqiraj - Çfarë të tërheqë?

Albana Vokshi - Të tërheqë në mënyrë urgjente propozimin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Kë propozim?!

Albana Vokshi - Musa, të lutem, dëgjoni, sepse për ju e kam.

Ismet Beqiraj - Ai prononcimi i sotëm çfarë ishte?!

Albana Vokshi – E kanë bërë një grup këshilltarësh, ja ku e ke shkresën. Ismet, të lutem, dëgjo!

E kanë bërë një grup këshilltarësh, ja ku e ke shkresën.

Ismet Beqiraj - Nuk dua të dëgjoj.

Albana Vokshi – Të lutem, ki pak respekt!

Ismet Beqiraj – Po, kam shumë respekt

Albana Vokshi – Të lutem, pusho!

Ismet Beqiraj – A nuk ishte prononcim politik ai?!

Albana Vokshi - Të lutem, pusho pak!

Ismet Beqiraj – Edhe ti e kupton, por do të bësh zhurmuesin. Kryeministri bëri prononcim.

Albana Vokshi - Të lutem, kam shumë respekt, mos e bëj më këtë rol!

Ismet Beqiraj – Unë nuk e bëra këtë rol...

Albana Vokshi – Mos ndërhy kur flas unë! Mbylle!

Ismet Beqiraj – Ju më pyetët dhe unë u prononcova.

Albana Vokshi - Të lutem, mbylle!

Ismet Beqiraj – Ju nuk e keni këtë kurajë, kur bëni gabim.

Albana Vokshi - Të lutem, më lër të mbaroj! Dreqi ta hajë, ki pak respekt!

(Diskutime pa mikrofon.)

Adelina Rista - Po ti, Albana, pse nuk të lë të mbarosh?!

Albana Vokshi – Adelina, dëgjoni dy këshilla për Kryeministrin. Po flas unë, më dëgjoni, sepse ju kam gjithë kohës...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ikni madje, sepse e keni...

Adelina Rista – Ju pse nuk i lini të tjerët të flasin? Të bëj që të mos flasësh!

Albana Vokshi – Morët urdhër?! Bëjeni, madje dhe ikni, sepse e keni....

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju morët urdhër? Adelina, është turp i madh!

Adelina Rista – Ashtu siç i ndërpret ti të tjerët.

Albana Vokshi - Të lumtë, Adelina! Bravo!

Adelina Rista – Albana nuk do të lë të flasësh, ashtu siç ti nuk i lë të tjerët të flasin. Po pse ma ndërpreve fjalën?! Pse më ndërhyre në fjalë?

Albana Vokshi - Ti, Adelina, nuk e bën dot këtë, sepse e ke në Rregullore. Mos u bëni absurdë dhe qesharakë.

Adelina Rista – Aspak nuk do t'ju lë të flisni. Kështu do të flas edhe unë pas teje, siç fole ti kur unë mora fjalën. Sa fillova dhe derisa mbarova, ti vetëm ndërhyre. Nuk më le të flisja. Me çfarë të drejte ti ndërhyr te fjala e tjetrit?!

Albana Vokshi - Turp!

Adelina Rista – Pse je kryetare, aspak nuk ke të drejtë?! Zonjë e nderuar, turp është për ty! Je kryetare, jo për t'i ndërhyrë tjetrit kur flet, dakord, por për të mbajtur rregullin. Sa keq të vjen tani që nuk të lë të flasësh, edhe ti respektoi të tjerët!

Albana Vokshi - Mirë, mbylle tani, sepse e kreve detyrën.

Adelina Rista – Fare nuk e mbyll, kështu do të bëj, gam-gam gjithë kohës, që të mos flasësh, sepse kështu e do ti. Dakord?!

Albana Vokshi - Mbylle, sepse nuk bëjnë femrat kështu!

Adelina Rista – Ti nuk ke të drejtë të flasësh gjithë kohës dhe të i mos lësh të tjerët të flasin. Provoje dhe ti se çfarë do të thotë kur të ndërpresin fjalën.

Albana Vokshi - E kreve detyrën, mbylle!

Adelina Rista – Jo, fare, aspak. Nuk e kam kryer detyrën, sepse nuk më le të flas. Sa mora fjalën dhe deri në fund, ti fole në vendin tim. Hape, zbardhe procesverbalin.

Albana Vokshi - Mbylle!

Adelina Rista – Ti, zonjë e nderuar, me çfarë të drejte ndërhyr te fjala e tjetrit?

Albana Vokshi - E kuptoj që sot jeni shumë në siklet.

Adelina Rista – Po të them edhe një herë, me çfarë të drejte ndërhyr te fjala e tjetrit?

Albana Vokshi - Mbylle tani!

Adelina Rista – Duhet të japësh përgjigje: pse ndërhyr te fjala e tjetrit?

Albana Vokshi - Mbylle se ta jap unë përgjigjen!

Adelina Rista – Po, ma jep përgjigjen.

Albana Vokshi - Mbylle!

(Diskutime pa mikrofon.)

Ki kujdes kur flet me mua!

Adelina Rista - Më jep përgjigje: ti pse ndërhysh te fjala e tjetrit? Zbardhe procesverbalin dhe shikoje fjalën time.

Albana Vokshi - Ore, jeni çmendur ju?! Ju jeni absurdë!

Adelina Rista – Po, nga fillimi i fjalës sime dhe deri në fund, ju vetëm keni folur. Hape procesverbalin kur të zbardhet.

Ti, zonjë e nderuar, me çfarë të drejte e mbyll fjalën time?!

(Diskutime pa mikrofon.)

Po, pra, e nderuar për atë që ke.

Albana Vokshi - Vazhdo, vazhdo...

Adelina Rista – Po, sepse ti e mbylle, tani do të flas dhe nuk do të të lejoj të flasësh.

Albana Vokshi - Jepi, jepi, jepi...

Adelina Rista – Po, do të flas.

Albana Vokshi - Po, fol, mos e mbyll. Vazhdo, vazhdo...

Adelina Rista - Zonjë e nderuar, nuk më lejove të flisja.

Albana Vokshi – Adelina, mos e ulni veten kaq poshtë.

Adelina Rista – Nuk do të flasësh fare, sepse mua nuk më lejove të flas, më ndërpreve fjalën.

Albana Vokshi – Mos e ul veten, sepse je deputete, përfaqëson njerëzit.

Adelina Rista – Fare nuk do të të lejoj të flasësh. Ta provosh se çfarë do të thotë t'i ndërpresësh tjetrit fjalën, sepse këtë komision dhe këtë mikrofon e ke kthyer vetëm për të folur për veten tënde. Prandaj nuk të lejoj të flasësh.

Albana Vokshi - Mbylle!

Adelina Rista – Kjo imja është një lloj demonstrimi, pra demonstroj kundër mënyrës se si e drejton ti komisionin.

Albana Vokshi - Po, bëj ankesë në formë institucionale.

Adelina Rista – Po, do ta bëj këtë, që të marrin vesh të gjithë se si e drejton ti komisionin!

Albana Vokshi - Edhe një herë bravo!

Mbani mend dy këshilla për Edi Ramën. Dy këshilla për Edi Ramën. E para: tërhiqe...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, Milva, mbaj qëndrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, unë do ta bëj deklaratën time. Të lutem, tërhiqe! Të lutem tërhiqe, sepse i kam respektuar të gjithë! Të lutem, tërhiqe, Milva!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të lutem, Milva!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Adelina, ke për të thënë ndonjë gjë? Do të shtosh gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po ik, moj grua, tani!

Dëgjoni këtu dhe mbani shënim! Dy këshilla për Edi Ramën: E para: tërhiq vendimin, tërhiq propozimin...

Adelina Rista – Asnjë këshillë. Nuk pranojmë asnjë këshillë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E dyta: thojini Edi Ramës...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina, unë mund të marr edhe forcat aty përjashta.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Thojini Edi Ramës, që të mos provokojë Hasin, të mos provokojë Kukësin...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

...të mos provokojë Tropojën, të mos provokojë shqiptarët, sepse ajo që bënë kuksianet është e vogël, Adelina, mbaje mend këtë që po të them.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zhurmuesin e bëre shumë mirë. Mbaje shënim këtë.

Adelina Rista – Po, dhe do ta bëj gjithmonë, sa herë të flasësh ti.

Albana Vokshi – Unë e kuptoj që ju jeni shumë të shqetësuar...

Adelina Rista – Jo, jo, të shqetësuar jeni ju!

Albana Vokshi – Mbani shënim: mos provokoni...

Adelina Rista – Foltoren e komisionit e përdorni si foltoren e Partisë Demokratike.

Albana Vokshi – Bravo të qoftë Adelina! As ti që bën zhurmuesin, as të gjithë ju...

Adelina Rista – Këtu unë do të bëj zhurmuesin. Boll më! Nuk ta lejoj asnjë çikë. Nuk të lejoj të flasësh fare!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e lejoj të flasë asnjëçikë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Jo, jo, nuk e kaloj këtë pikë, jo. Unë e kuptoj që ti, Adelina, shqetësohesh...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Nuk shqetësohem fare!

Albana Vokshi – Edi Rama të mos provokojë... Shënoje, shkruaje!

Edi Rama të mos provokojë, se Kukësi do t'i duket lule. E kuptoni këtë apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – ... e mori vesh e gjithë Shqipëria, kur u prononcua, që në mëngjes.

Albana Vokshi – Se një grua s'e bën këtë rol.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Baçi – Adelina thjesht bën zhurmuesen. Mua më ke habitur sot, Adelina, por më ke bërë edhe qejfin, sepse vjen nga Fieri dhe je vërtet shumë e zonja në të folur, je e paparë në të folur. Bravo Adelina! Duartrokitje të dhamë, fletë-lavdërimi do të të japim. Çfarë tjetër do më ti, Adelina? Do të t'i japim të gjitha.

Adelina Rista – Nuk kam nevojë fare. Për asgjë nuk kam nevojë.

Luan Baçi – Shiko, se do të kesh nevojë për ndonjë gjë.

Adelina Rista – Ta drejtojë mirë komisionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Baçi – Dëgjo: Edi Rama është Kryeministri dhe Kryeministri ka detyrime, se është Kryeministër i të gjithë Shqipërisë. Lulzim Basha është kryetar i opozitës. Ju mos bëni të njëjtën punë që bëjmë ne, por bëni punën dhe detyrën tuaj, se e keni shumë gabim. Më mirë të flisni si Adelina, bjerini tavolinës dhe flisni kodra pas bregut.

Adelina Rista – Të lutem, nuk e kam për edukatë e ti më njeh mirë.

Luan Baçi – Po, unë të njoh, ndaj më vjen keq.

Adelina Rista – Jam në të drejtën time.

Luan Baçi – S'je në të drejtën tënde sot, këtu.

Adelina Rista – Jam në fjalën time. Isha në minutazhin tim.

Luan Baçi – Nuk mund t'i bësh karshillëk ti kryetares së komisionit, me fjalë kot.

Adelina Rista – Me ç'të drejtë kryetarja e komisionit më ndërpret fjalën?

Luan Baçi – Nuk ta ndërpret fjalën. Asnjëherë nuk ta ka ndërprerë fjalën.

Adelina Rista – Hape procesverbalin!

Luan Baçi – Asnjëherë nuk ta ka ndërprerë fjalën, absolutisht.

Adelina Rista – Po, nga fillimi deri në fund.

Luan Baçi – Absolutisht! Ti Adelina rri e rri, e nganjëherë shpërthen në mbledhje.

Adelina Rista – Asnjë fjalë, fare, fare!

Albana Vokshi – Turp i madh! Gjynah!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luan Baçi – U prononcove kundër dekorimit të Mazrekut?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Leri ato, se s' të shkojnë me mua!

Luan Baçi – Prononcohu kundër!

Adelina Rista – Leri ato, se s' të shkojnë me mua, Luan! Boll luajte! Do të marrësh pikë në Fier ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – O Luan, po ne deputetët e Fierit do të bëjmë kështu, gërr-gërr?

Albana Vokshi – Gjynah Fieri, ku jeni katandisur!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Sigurisht, më vjen keq për çka ndodhi këtu. Adelina duhet të jetë më e kujdesshme...

Adelina Rista – Të lutem...

Valentina Duka – Është mendimi im.

Adelina Rista – Të ndërhyj te fjala jote tashti unë?

Valentina Duka – Po s'ke të drejtë të ndërhysh, se unë jam deputete njësoj si ti.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Valentina Duka – Unë mendoj se gjithçka që u tha teknikisht këtu për mbylljen e portalit, ishte një alibi për arsye politike të mbylljes së portalit. Nuk jam kurrësi dakord me mbylljen e portalit. Bashkohem me fjalët e kolegëve të mi, që portale të tilla mbyllen vetëm në vende diktatoriale. Albana solli si shembull Azerbajxhanin, por ka edhe portale të tjera të vendeve ish-komuniste, që kanë hapur gjyqe në Gjykatën e Strasburgut kundër vendimit të qeverive të tyre në lidhje me mbylljen e portaleve. Nuk ndodh në asnjë vend përëndimor. Në vendet përëndimore nuk është çuar asnjë portal në gjyq. Kjo ndodh vetëm në vendet diktatoriale. Prandaj, deputetë, ju lutem që emri i Shqipërisë të mos jetë më në Strasburg përkrah Azerbajxhanit apo ndonjë shteti tjetër që mbyll portalet.

Urdhërojeni Kryeministrin tuaj ose kërkojini Kryeministrit tuaj, kërkojini drejtorëve të nderuar që kemi këtu, që të mos mbyllin më portale opozitare, sepse jemi një vend demokratik, që aspirojmë të bëhemi pjesë e BE-së.

Faleminderit!

Albana Vokshi – Keni pyetje të tjera, apo t’ia japim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, pse ta mbyllim tani? Tani s’e mbyllim. Tani të vazhdojmë me shumë qetësi, pa dashuri, por me shumë qetësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Do të vazhdojmë, sepse mua nuk më shqetëson dot jo Adelina, por askush tjetër. Unë bëj punën time dhe do ta bëj me korrektesë.

Adelina Rista – A ka mundësi ta drejtosh mbledhjen?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nuk të fola.

Adelina Rista – Drejto mbledhjen!

Albana Vokshi – Dhe do ta bëj me korrektesë, Adelina, pavarësisht nga detyra që merr apo nuk e merr dhe e bën me vullnetin tënd të plotë, se kujtoni se do të promovoheni. Respekto kolegët, të lutem.

Adelina Rista – Do t’i lësh këto?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti ke nevojë për promovim. E bën PR aq mirë ti, sa s’ka më! Se për PR e bën atë punë. Prandaj, shiko punën! Unë s’kam nevojë të promovohem.

Albana Vokshi – Shumë mirë, por mos e bëj këtë. Mos e bëj, se është rol shumë i shëmtuar. Lexo Rregulloren, lexo çdo nen të Rregullores, sepse Rregullorja...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Jo, jo me ty! Lexo nenet e Rregullores, që janë shumë të qarta: si organizohen mbledhjet? Kush e merr fjalën? Kujt i jepet fjala?

Adelina Rista – Dhe kujt i ndërhyhet në fjalë.

Albana Vokshi – Kujt i jepet fjala...

Adelina Rista – Kujt i ndërhyhet në fjalë...

Albana Vokshi – Epo, dëgjo, kujt i jepet fjala. Merreni e lexojeni, se ju s’lexoni kurrë. Hapni librat dhe lexoni.

Adelina Rista – Je kryetare, mos ndërhyj në fjalë! Për këtë po protestoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Nëse ty, Adelina, nuk të pëlqen mënyra se si unë drejtoj...

Adelina Rista – Jo fare, mënyra se si ndërhysh te fjala e tjetrit.

Albana Vokshi – ...do të thotë... Ah, sa femër pa edukatë!

Do të thotë se unë po e bëj punën time shumë mirë. Kjo më bën ta vlerësoj punën time dhe të kolegëve të mi. Për aq kohë sa ju shqetësoheni kaq shumë, sepse po dalin problemet.

Edhe një herë, të këshilloj që të mos guxosh të presësh fjalën e kolegëve e as timen!

Adelina Rista – Mos guxo ti të ndërhysh te fjala e tjetrit.

Albana Vokshi – Mbani shënim sugjerimet që kemi për Kryeministrin!

Adelina Rista – Për sa kohë të ndërhysh në fjalë, unë nuk do të lejoj të flasësh. Unë do të ndërhyj. Kjo është një protestë e imja, që ka të bëjë me mënyrën se si ti e drejton komisionin.

Albana Vokshi – Nëse ty të vjen keq, që këtu flitet për nderimin e vrasësve e për mbrojtjen e kriminelëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Mos e bëj këtu, bëje te mikrofonin i partisë tënde.

Albana Vokshi – Kryeministri mos të provokojë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kryeministri mos të provokojë. Çojini fjalë: mos guxo as me Hasin, as me Kukësin, as me Tropojën, as me të gjithë shqiptarët. Nuk guxon ai të nderojë vrasësit!

Adelina Rista – Shko e thuaji këto te selia e SHQUP-it, jo në komision!

Albana Vokshi – Nuk mundet ai të vrasë për herë të dytë tribunin e demokracisë!

Adelina Rista – Shko e thuaji atje, jo këtu!

Albana Vokshi – Jo, jua them këtu, sepse juve ju jep porosi dhe vini e i lexoni këtu. Kështu që, herë tjetër mos u bëni pjesë e lojës së shëmtuar! Mos u përdorni, ju lutem! Kini qëndrimin tuaj! Një pjesë prej jush jeni kolegë të nderuar. Ruajini vlerat, nëse i keni, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

S'i prishni dot komisionet kështu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, ju lutem...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Një minutë, për procedurë!

Në të gjithë këtë histori midis Albanës dhe Adelinës, një gjë është e qartë. E kuptoni sa keq është kur na ndërpritet fjala, kur i ndërhyjmë njëri-tjetrit? Është një gjë që nuk duhet të ndodhë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Romeo Gurakuqi – Ka katër muaj që s’na lini të flasim.

Milva Ekonomi – Ne s’ju lëmë të flisni?!

Romeo Gurakuqi – Katër muaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Adelina Rista – Përkundrazi, ju dëgjojmë me shumë respekt, ju dëgjojmë me shumë qetësi të gjithëve. Të gjithëve ju dëgjojmë me respekt e me qetësi, e keni shumë gabim, përveç kryetares, e cila ndërhyr te fjala e të gjithëve. Ju dëgjojmë me shumë respekt.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – A u qetësove tani?

Adelina Rista – Sot e bëra pikërisht për protestë, që kryetarja ta provojë se ç’do të thotë të ndërhysh.

Albana Vokshi – Bravo! Bravo! Të lumtë Adelina, të lumtë! Sot e ke kryer detyrën shumë mirë.

Bujar Çela – Për procedurë, tridhjetë sekonda!

E bëmë maratonë këtë mbledhje, si gjithmonë. Të na falin edhe një herë përfaqësuesit e institucioneve, por duhet ta përsëris, që të saktësojmë një gjë: përderisa është distancuar Kryeministri i kësaj maxhorance, kryetari ynë, me ato që tha vetë nënkryetarja e komisionit, nuk e di pse i bini më këtij defi. Hapni sytë, se ai qytetar nderi nuk është bërë në të gjithë Shqipërinë, por është bërë atje, dhe është bërë së bashku me votat e PD-së. Saktësojini këto e pastaj filloni e bjerini një qemaneje tjetër.

Albana Vokshi – Edhe një herë: ai që ju sot keni propozuar që të nderohet “Qytetar Nderi” i Hasit ...

(Diskutime pa mikrofon.)

... nuk i përket vetëm Hasit, nuk i përket vetëm Tropojës, nuk i përket vetëm Kukësit, por gjithë Shqipërisë, ndaj dhe reagimi do të jetë proporcional. Këto ju thashë unë, tregojani Edi Ramës...

(Diskutime pa mikrofon.)

Azem Hajdari i përket gjithë Shqipërisë, prandaj po them edhe unë që të tërhiqini këshilltarët bashkiakë. Jepini urdhër që ta tërheqin vendimin!

(Diskutime pa mikrofon.)

Urdhëroni!

Elisa Stamo – Jam juriste në Autoritetin Kombëtar të Certifikimit Elektronik dhe të Sigurisë Kibernetike...

(Diskutime pa mikrofon.)

Autoritetit të Komunikimeve Elektronike ne i jemi drejtuar konkretisht. Duke qenë se faqja e internetit *online kryeministri.com* bënte një direktim, edhe ajo që ju sapo sqaruat më parë, kur po flisnim për këtë çështje, është konkretisht një *fishing*, sepse bën direktim në një nga faqet që quhet *shqiperiaqeduam.al*, e cila nuk është anonime, që ti të mund të futesh, ti, unë e kushdo tjetër, dhe çdo qytetar i Shqipërisë të mund të futet në këtë faqe. Duhet patjetër të regjistrohet në një kartë identiteti, ndryshe nuk të lejon të futesh në faqe.

Në këtë moment duke drejtuar e-maile pa fund në këtë faqe, ti bën konkretisht atë që ligji na detyron të ruajmë, një parandalim të një incidenti kibernetik, sepse faqja e “Shqipëria që dua” është e lidhur drejtpërdrejt me *ialbania* dhe zyrën e përgjithshme të gjendjes civile dhe në këtë faqe na krijon një mundësi për të hapur një portal, i cili në vetvete krijon atë çka ne po përpiqemi të mbrojmë, sigurinë kibernetike të këtyre faqeve zyrtare. Në qoftë se kjo ju duket e pamundur, mund ta verifikoni automatikisht, të gjithë mund të futemi te “Shqipëria që dua” dhe ta verifikojmë

U përpoqëm të kontaktojmë me ata që kanë krijuar faqen për t’i kërkuar që, ju lutem, në momentin që ju hiqni direktimin në një faqe të portalit zyrtar, aktualisht ndër më të rëndësishmit, nuk kemi asnjë pikë kontakti dhe nuk mund të kontaktojmë në këtë pjesë. Për këtë arsye i bëmë bllokimin e pjesshëm faqes për momentin. Në momentin që ata indo@ces.gov.al është një email zyrtar ku mund të çojnë një e-mail në të cilin të tërheqin këtë e-mail kur i drektojnë, kam përshtypjen që me bashkëpunimin e AKEP-it do të jemi shumë të aftë për ta zhbllokuar faqen brenda momentit.

(Diskutime pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po çfarë po bëni more? Po çfarë kujtoni ju se duke bërë titur mund të më impresiononi mua?! Po mos guxoni ta bëni, pra...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ti, as ti, as ti mos më bërtisni mua! Ruani etikën!

(Diskutime pa mikrofon.)

S’ia dilni dot me argumente dhe filloni bërtisni, fyeni, prishni komisionin ...

(Diskutime pa mikrofon.)

Jam shumë e nderuar kur ti i nxjerr nga goja këto fjalë.

(I drejtohet deputetit Ulqini që flet pa mikrofon.)

Kush të tha ty se do ta lejoja? Kush të tha?

Qetësohuni more, se s'qenkeni në terezi fare!

(Diskutime pa mikrofon.)

Elisa Stamo – Doja të shtoja se Autoriteti në vetvete nuk është marrë me përmbajtjen e faqes. Nuk merret dhe nuk e ka në ligjin e vet të merret me përmbajtjen e faqes, por ka bërë ndërhyrjen vetëm në momentin që ky sistem drekton një nga infrastrukturat kritike tonat, zyra e Gjendjes Civile është një infrastrukturë kritike për shtetin shqiptar në këto momente.

E dyta, më thatë që “Shqipëria që dua” është anonime dhe në këtë rast po ju përgjigjem se jo. Duhet të regjistrohesh me kartën e identitetit dhe akseson në sistem, nuk është një faqe dosido.

Për e-mail-in që ju i keni drejtuar Autoritetit dje në darkë, në orën 12:15, në mos gabohem, mund t'ju them që do të merrni një përgjigje konkrete dhe të bazuar, sepse ne nuk merremi me përmbajtjen e asnjë faqeje facebook-u në vetvete, apo faqe online, apo interneti. Në momentin që ajo shkel sigurinë, kemi ndërhyrë. Kjo është e vetmja gjë që ka bërë Autoriteti në këto momente.

Megjithatë, ju do të keni një përgjigje zyrtare siç e keni kërkuar përmes e-mail-it.

Albana Vokshi – Ju lutem, na dërgoni të gjitha përgjigjet sipas rendit që jua kemi dërguar dhe sipas pikave dhe nënpikave, sepse kjo mund ta bëjë më të qartë. Në momentin që ju nuk na keni dërguar asnjërën prej pikave që ne kemi kërkuar, e kemi shumë të vështirë të dimë çfarë ka ndodhur realisht.

Urdhëroni!

Endri Hasa – Mua më vjen keq, nuk kam asgjë me profesionin e juristit, por nuk e dija që siguria kibernetike ruhet me juristë. Ky ishte konstatim.

Pyetja është shumë konkrete: Meqë ridirektimi për te faqja “Shqipëria që duam” përbën cenim të trafikut të kësaj apo asaj, bllokojini të gjitha faqet e ministrave, faqet në *facebook* të ministrave, të deputetëve dhe të çdo njeriu që ka bërë sherr në këtë faqe dhe që sillka trafik! A e kuptoni se çfarë po flisni? Këtu është gabimi edhe i zonjës Tomço që ju ka marrë ju të flisni si juriste. Duhet të kishte sjellë ata që janë te siguria kibernetike të flisnin dhe të na shpjegonin këtu se cili është *fishing-u* që bëka faqja. Sa për sistemet, unë i njoh aq mirë, njoh sistemet, ndërlidhjet, ndërveprimin, se si është bërë ai sistem, se ku lidhet. Kërko projektin dhe gjej autorin! Kështu që mos më fol mua as se si u krijua, as për detyrat që ka, as për sistemet që

mbron dhe as për gjëra të tjera, sepse këtë çështje e kam ndjekur në zanafillë. Në qoftë se doni të ktheni përgjigje, ju minimalisht, meqë jeni juriste, të ishit përgjigjur me ato çka përmban ligji, raportin e incidentit, dhe ne e vlerësonim se cili është autori i kërkesës. Thuajeni autorin! Pyetje bëmë ne. Kush kërkoi të mbyllej faqja? E kërkoi Edi Rama? E kërkoi Romeo, x-i, y-i, nuk ka rëndësi. Ne kemi pyetje konkrete. Pse trembeni dhe nuk e sillni? Mos u xhironi rreth arsyes se “çonte trafik”? Po kjo është qesharake, se me këtë logjikë, një nga faqet e para që ka bërë reklamë për “Shqipëria që dua” është faqja e Kryeministrit. Atëherë, ta mbyllim ne se çoka trafik? Nuk është faj se “çon trafik”, ky nuk është element teknik, prandaj mos u fshihni pas çështjeve dhe llafeve të bukura ligjore. Në qoftë se doni përgjigje ligjore, minimalisht, sillni ato pikat që përmban neni përkatës, ku i keni dokumentacionet që keni administruar ju derisa keni vajtur me kërkesë të AKEP-it. Deri në momentin që vajtët me kërkesë të AKEP-it, çfarë dokumentacioni keni administruar? Kjo është pjesa ligjore.

Pjesa teknike, që kjo nuk është *fishing*, nuk ka njeri që ta thotë ndryshe. Kjo nuk është *fishing*. Ne duam të dimë përgjegjësinë konkrete ligjore të personit që në burim, se kush e ka cilësuar, kush e denoncoi dhe, më pas, kush është personi teknik që ka vënë firmën për të vërtetuar se është *fishing* dhe t’ia kërkojmë përgjegjësinë personit që ka bërë gabimin. Ka bërë gabim, nuk është *fishing* dhe nuk ka ekspert në botë që të thotë se është *fishing*. Këtu nuk është çështja për një portal çfarëdo, nuk ka lidhje fare portali, këtu është cenim i parimit. Këtu me një të rënë të lapsit po i mbyllim të gjitha, me një teknikallitet për të mbyllur portalet e basteve *online* për shkak të një ligji të posaçëm për këtë gjë, ka ndonjë vendim gjykatë për ta mbyllur këtë gjë që ka kontent? *Fishing* nuk ka aty. Atëherë, na thoni kush është personi i identifikuar si *fishing* dhe sillni raportet e incidentit dhe gjithë detyrimet e tjera me pika sipas ligjit.

Herë tjetër, zonja Tomço, ose ktheni përgjigje vetë, ose sillini teknikët këtu të kthejnë përgjigje!

Albana Vokshi – Urdhëroni, për një sqarim!

Luçiano Boçi – Kam edhe një sqarim për përgjigjen e juristes, sepse ajo tha se ne si Autoritet nuk merremi me faqet *online*, me përmbajtje të paligjshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

“Me përmbajtjen e faqes”. Po, ky është shqetësimi ynë konkret që ka të bëjë me funksionimin e autoritetit tuaj, sepse juve ju njihet e drejta që në bazë të një ankimi të autoritetit publik të bëni mbylljen e faqes. Unë jo më kot ju kam dërguar *e-mail*-in, por në justifikimin tuaj shkresor ju shpreheni: “Ne nuk kemi mundësi, sepse faqja nuk funksionon. Ne kemi zgjedhur rrugën alternative”. Pra, ju bini në kundërshtim me veten tuaj. “Nuk e kemi

kryer detyrën e bllokimit të faqes, sepse faqja unike *online* nuk funksionon. Ne kemi ndjekur rrugën e krimit kibernetik”. Kjo është përgjigjja juaj me shkresë. Kjo do të thotë se qëllimi juaj është mbyllja e faqes nëpërmjet portalit *online*, që ju e administroni. Ju thoni se faqja nuk funksionon. Po, atëherë si e morët *e-mail*-in tim, kur faqja nuk funksionon? Unë e kam faqen këtu përpara, është *black liste*.

Të lutem, ta mbaroj!

Ja ku është *black liste*!

Kjo është faqja dhe janë adresat e IP-ve dhe të faqeve që ju i bllokoni në bazë të kërkesës së autoriteteve publike. Ndërsa nga ana ligjore, ju e keni si detyrë të përcaktuar në VKM-në nr. 142 që faqet me përmbajtje të paligjshme konstatohen nga autoritetet publike dhe dërgohen zyrtarisht pranë autoritetit, i cili u mundëson atyre të drejtat e aksesit në sistem për publikimin e tyre, me qëllim mbylljen e këtyre faqeve. Mbyllja e faqeve është detyra juaj. “Autoriteti nxjerr udhëzime për funksionimin e sistemit, duke përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e autoriteteve publike, si edhe të ofruesve të shërbimit të internetit”. Keni 1 vit që jeni krijuar dhe nuk keni nxjerrë asnjë udhëzim për mënyrën se si duhet të veprojë autoriteti publik dhe si kryhet procedura e bllokimit. Në gjendjen aktuale që jemi ne, situata është e tillë që çdo autoritet mund të bëjë kërkesën dhe ju mbyllni një faqe *online*, medie *online* për arsye se autoriteti e gjykon të paligjshme. Ju nuk e vërtetoni dot. Ju thoni: “Unë nuk merrem me përmbajtjen e paligjshme”. Përmbajtje e paligjshme, sipas vendimit tuaj, është VKM-ja për ju, pra përmbajtjen e paligjshme e konstatoj unë. Po, po! Këtu është drama, sepse nëse unë them se portali x ka përmbajtje të paligjshme, ju nuk e verifikoni dot. Si do ta bëni verifikimin? Ju keni për detyrë ta mbyllni direkt. Atëherë, plotësoni kërkesën time dhe mbyllni ERTV-në, është shumë e thjeshtë. Nuk po kërkoj faqe tjetër *online*, se ky është kuadri ligjor mbi bazën e të cilit ju veproni.

Elisa Stamo - Bëjmë fjalë vetëm për infrastruktura kritike. Nuk mund të mbyllim faqe që nuk...

Luçiano Boçi - Në raport me direktimin ose bërjen sherr, siç tha edhe Endri, nuk jemi në kufijtë e *fishing-ut*. E thamë: çfarë *fishing*-u keni parandaluar ju, kur unë mund t’i gjej me IP? Po iki në Mal të Zi, po hyj në faqe, nëse do të bëj *fishing*, po marr të gjitha të dhënat e qytetarëve shqiptarë. Çfarë keni bërë ju? Ku është puna juaj si autoritet? E keni bërë për të mbuluar aksesin për lexuesit shqiptarë brenda territorit. Është fare e thjeshtë dhe e dukshme, sepse *fishing*-un nuk e keni bllokuar dot dhe nuk e bllokoni. E dini shumë mirë se me një VNP thjesht unë hyj te faqja, apo jo? Me fshehje IP-je, ka 100 programe për fshehje të IP-së.

Atëherë, çfarë autoriteti jeni ju, përse paguheni? Për t'u mbyllur gojën medieve *online*? Ju nuk mbronin të dhënat. Ju e pranoni vetë se nuk keni infrastrukturë për të mbrojtur këtë të dhënë, që unë e kam personale, kartën e identitetit dhe gjërat e tjera.

Arsyet që keni sjellë janë krejtësisht absurde edhe nga ana teknike, por edhe nga ana ligjore.

Albana Vokshi- Faleminderit!

Keni ndonjë gjë për të shtuar?

Vilma Tomço - Të vetmen gjë që do të thosha është se ne menaxhojmë infrastrukturën kritike. Jemi koordinatorë dhe administratorë të asaj platforme *online*, që fatkeqësisht i kanë mbaruar licencat dhe jemi në tratativa për ta vënë në punë. Janë infrastrukturën kritike ato që hedhin në këtë portal dhe duhet të aksesojnë për të kërkuar mbylljen. Nuk jemi ne. Në momentin e kësaj mungese, në momentin kur ky portal nuk funksionon, atëherë veprojmë ne. Kjo është historia.

Zotëria vërtet ka hyrë në portal, por nuk ka të drejtë aksesimi në të. Në portal aksesojnë dhe japin “urdhra” vetëm ata që janë konsideruar dhe kanë statusin “infrastrukturë kritike”. Aktualisht në këto momente e ka vetëm AMF-ja, AKSH- i edhe një institucion tjetër AMLF-ja që është Autoriteti për Mbrojtjen e Fëmijëve *Online*. Këta kanë të drejtën të kërkojnë...

Albana Vokshi – Kush e ka bërë kërkesën te juve?

Vilma Tomço - Këtë e kemi gjetur, sepse ne jemi njëkohësisht monitorues dhe auditues, ka qenë kryesor dhe kontrollues. Pra, jemi vetë në këtë gjë. Ne do ta hedhim vetë në sistem, do ta bëjmë vetë dhe do t'ju sjellim juve.

Albana Vokshi- E keni bërë juve, nuk keni marrë kërkesë? Kjo është?

Vilma Tomço - E kam thënë edhe në shkresë që sistemi ynë, operatorët tanë e gjetën dhe e raportuan te ne. Është kjo faqe që ka këtë dhe këtë mangët dhe po sjell trafik në këtë drejtim.

Albana Vokshi- Ne praktikën duam, shkresat zyrtare, si e kanë raportuar te ju?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vilma Tomço - Janë brenda ekipit.

Albana Vokshi- Nuk ka rëndësi, parlamentit duhet t'ia dërgoni të gjitha, bazuar edhe në nenin e ligjit; nëse është konfidenciale, ruhet konfidencialiteti.

Elisa Stamo - E njëjta gjë. Duhet të thuhet se ajo faqe që të ketë legjitimitet duhet të ketë të paktën 1 pikë kontakti.

Albana Vokshi - Ju lutem!

Nuk e vë në dyshim fare këtë. Ne kemi kërkuar procedurën, të brendshme apo ndërinstitucionale. Juve jeni të detyruar të na i dërgoni. Deputetit nuk i mbahet asnjë informacion.

Luçiano Boçi – Ju e pranoni se nuk e keni arritur qëllimin. *Fishing*-un ju nuk e ndaloni dot. Ju thoni: “Nuk e ndalojmë dot”. Pse bllokoni faqen, kur nuk e ndaloni dot?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pse ju bllokoni informacionin për këtë faqe?

Fishing-un ju nuk e bllokoni dot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po përpiqeni? Si po përpiqeni, duke u mbyllur gojën portaleve?

Albana Vokshi - Zonja Rista, ju kishit për të folur?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju kërkoj ndjesë!

Luan, të lutem, mos ia ndërprit fjalën, sepse pastaj Adelina do ta nisë nga e para.

Adelina Rista – Unë do të flas. Kam të drejtën e fjalës.

Albana Vokshi- Adelina, të lutem, mos e bëj kaq banale!

Ta kam dhënë fjalën dhe i thashë Luanit: “Mos e ndërprit!”.

Adelina, mos u bëj absurde, vazhdo tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ky është problem, Ismet, dhe unë do ta kërkoj, të mos hapen më shumë se 2 mikrofonë, që të mos bëhet pazar, siç e bëni ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë dhe të gjithë kryetarët e mbajnë mikrofonin të hapur gjithë kohën, që ta dini, por edhe do të diskutojmë...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Që ta sqaroj, që të mos e hapësh ti, unë do të kërkoj të bëhet ndërhyrje. Në rregull? Asnjë komision tjetër nuk e bën mbledhjen pazar, siç e bëni juve.

Të lutem, ia kam dhënë fjalën koleges tënde, Adelinës! Mos e ndërprisni!

Milva Ekonomi – Ismet, lëre të flasë Adelina!

Ismet Beqiraj - Po, do ta lë të flasë. Ne kemi duruar 10 muaj, do të durojmë edhe sa i bie?

Adelina Rista –Do t’i qëndroj asaj që nisa të them që në fillim. Personin x, y, zeta apo beta, quajeni si të doni, që fshihet pas asaj faqeje, që nuk ka administrator, nuk ka numër

telefoni, nuk ka adresë *e-mail*-i, për të cilin të gjithë po bini përmbys se pse i është mbyllur faqja, a mund ta njohim se cili është, ta dëgjojmë këtu, se i është prekur interesi, i është mbyllur faqja?

Zonja kryetare, na e sillni, që ta dëgjojmë, meqenëse i është prerë liria e fjalës, meqenëse i është zënë zëri në grykë atij, a ka mundësi të na e sillni? E çova në këtë nivel bisedën, që ta kuptojnë ata njerëzit jashtë se për çfarë po bëjmë fjalë këtu. Dakord?

Albana Vokshi- Mbaruat?

Adelina Rista- E zbrita në këtë nivel, që ata njerëzit e thjeshtë jashtë, në arrë ku punojnë e kudo ta kuptojnë se për çfarë po bëjmë fjalë ne.

Albana Vokshi - Jam shumë dakord me këtë që thua Adelina. Jam shumë dakord me propozimin tënd.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Zoti Musa, meqenëse kërkon etikë, të paktën përmbahuni!

Jam shumë dakord edhe unë që ky personi apo ata, ato nuk ka rëndësi fare, brenda legjislacionit, brenda kushteve të legjislacionit të japë adresën, *e-mail*-in, siç e ka legjislacioni, duke respektuar legjislacionin. Por të njëjtën gjë duhet të bëjnë edhe shumë portale të tjera që kanë ministrat tuaj, apo portale të tjera që kanë kryetarët e bashkive tuaja. Unë jam shumë dakord që përhapin edhe *fake news* nga mëngjesi deri në darkë. Sulmojnë opozitën, sulmojnë miq të Shqipërisë brenda dhe jashtë. Jam shumë dakord të bëjmë transparencë, se kush ka njërin dhe kush ka tjetrin, paratë që financojnë njërin dhe paratë që financojnë tjetrin, a janë para nga taksat e mia, tuajat dhe të qytetarëve shqiptarë apo janë para të krimit që financojnë këto portale?

Hajdeni të bëjmë transparencë! Jam shumë dakord me propozimin tënd, por të thuash ti: “Pse u shqetësuat ju se mbyllet një portal”, mua më ven keq, sepse po flasim për lirinë e shprehjes, për lirinë e fjalës, për lirinë e portaleve, për lirinë e medieve. Nëse ti thua....

Adelina Rista- Flasim për sigurinë, jo për lirinë.

Albana Vokshi - ... unë do t’ia lë atij portalin, por nëse e shikoj, e kam qejf, më pëlqen, unë do t’ia hap atë.

Mos më ndërhy, kur flas unë! Nuk e kontrolloni veten kur u ndërhyni të tjerëve.

Nëse unë ty të pëlqej dhe nuk je kritik, unë ta hap portalin; nëse unë ty nuk të pëlqej, ta mbyll brenda 2 orësh portalin dhe kam nën varësinë time të gjitha institucionet. Jap një urdhër dhe brenda ditës ta mbyll. Prandaj jemi këtu për të folur, sepse e ke kusht, e ke kriterin numër 1 të hapjes së negociatave, e ke kriterin numër 1 në të gjithë rrugën për procesin

e integritit. Përtej kësaj unë nuk di se si mund të mos e kuptoni këtë, se nuk bëhet fjalë për një portal, për një person të caktuar, por bëhet fjalë për lirinë e medias, për lirinë e shprehjes, për lirinë e shtypit. Nuk e ktheni dot në censurë ju, dhe mos guxoni ta bëni. Kur them ju, e kam fjalën për ata që janë mbi kryet tuaja. Nuk e censuroni dot. Mos na ktheni në diktaturë, sepse reagimi, po e përsëris, nuk do të jetë më në nivele, por do të jetë propocional me atë çfarë po i bëni këtij populli. Kaq kisha unë.

Faleminderit, për pjesëmarrjen!

Ju lutemi të na dërgoni të gjitha informacionet, sikurse i kemi kërkuar, pikë për pikë dhe për çdo nënpikë.

Nesër në orën 10:00 kemi mbledhje, sikurse është kërkuar nga një numër deputetësh të opozitës, me ministren e Kulturës, e cila e ka konfirmuar që do të vijë. Gjithashtu kemi edhe emrat e stafit, të cilët do t'jua dërgojë Ariana.

Për kërkesën tuaj jemi shumë dakord të bëjmë një dëgjese tjetër, të përbashkët, por çështjet që ne duam të trajtojmë me ministren e Kulturës janë të pavarura nga ato që duam të trajtojmë me kryetarin e Bashkisë, Veliaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E bëjmë bashkë edhe atë. Jemi shumë dakord, vetëm caktoni ditën.

Milva Ekonomi – Ne thamë që të bëhet dëgjesa me të dyja palët, me ministrin e Kulturës dhe me kryetarin e Bashkisë, gjithashtu të kemi edhe përfaqësues artistësh në takim.

Albana Vokshi – Nesër e kemi të ndarë, sepse kemi çështjen e projektligjit dhe kryetari i Bashkisë nuk ka lidhje me projektligjin, fare.

Milva Ekonomi – Po, pra, edhe kryetarit të Bashkisë i keni vendosur si kërkesë çështjen e projektligjit, sepse i lexuam pyetjet.

Albana Vokshi – I kemi bërë të ndryshime. Vetëm rolin që ka ai si pjesë e projektligjit.

Milva Ekonomi – Ndërkohë, ka dy gjëra që janë të barabarta me kërkesat që kemi bërë.

Vilma, të lutem a mund ta mbaroj unë?

Ne kemi bërë kërkesë për një takim në orën 10:00 me të dy përfaqësuesit dhe axhenda e takimeve të mos ndryshojë nga kërkesat tuaja. Të vijnë ata të dy këtu së bashku, me një përfaqësi prej jo më shumë se 10 vetash nga artistët. Ne këtë kërkesë kemi depozituar. Nuk është e ndryshme nga kërkesa juaj, është njësoj.

Albana Vokshi – Unë u konsultova edhe me deputetët e tjerë të PD-së dhe të LSI-së, dhe insistojmë që nesër të jetë veç Ministria e Kulturës, siç e kemi kërkuar, sepse duam ta ndajmë pjesën e projektligjit që është krejt më vete, duke trajtuar edhe pjesën ligjore, pjesën e

shkeljes së neneve, sipas asaj që ne mendojmë, të Kushtetutës e të tjera. Ndërkohë, me kryetarin e Bashkisë ne do të diskutojmë për çështje të pronës, tjetërsimit të pronës e të tjera. Prandaj duam që t'i ndajmë.

Milva Ekonomi – Ne mund t'i ndajmë edhe duke i pasur bashkë, por ne kemi vendosur që të bëjmë mbledhjen këtu. Ne kemi bërë edhe kërkesë, mund ta hedhim edhe në votim.

Albana Vokshi – Nuk mund ta bëni ju në të njëjtin orar që kemi kërkuar ne. Këtë nuk mund ta bëni. Merreni të paktën në kronologji.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E kemi të vendosur në kalendar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por vendoset me Rregullore, moj Vilma!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Lëre se nuk të ecën kjo e firmave false!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Atëherë, çfarë do të bëni nesër ju? Do t'i sillni paralelisht?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk e bëjmë dot me votë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Por nuk e hidhni dot në votë! E përcakton edhe Rregullorja, me një të tretat automatikisht futet në kalendar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk mund të bëni kërkesë mbi kërkesë.

Vilma Bello – Mbledhja e komisionit bëhet e vlevshme nëse është më shumë se gjysma e antarëve prezent.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Doni ta bojkotoni? Bëjeni se e keni bërë edhe herë të tjera!

Vilma Bello – Jo, se ju e keni bërë mbledhjen, duke mos qenë më shumë se gjysma e anëtarëve prezent. Se kështu ishte edhe mbledhja e radhës së kaluar.

Albana Vokshi – Nuk kemi trajtuar çështjet e mbledhjes. S'jemi futur fare në çështjet e mbledhjes.

Vilma Bello – Unë them se duhet ta hedhim në votë këtë çështje, sepse kërkesat nuk janë të ndryshme, janë të njëjta. Ndërkohë, në gjithë këtë kohë, po dëgjojmë në opinionin publik

që të dyja figurat shkojnë bashkë dhe bëjnë dëgjesa. Ne themi që nesër ta bëjmë dëgjesën me të dy.

Albana Vokshi – Përse ka frikë Mirela që të vijë vetëm? Ajo është e zonja vetë, sepse edhe me artistët ajo foli një orë.

Vilma Bello – Nuk është frika e Mirelës. Mbase është frika juaj në këtë rast.

Albana Vokshi – Le t'i ndajmë, më vete njërin dhe më vete tjetrin, çfarë frike është?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Luciano Boçi – Ne do të bëjmë seancën dëgjimore siç e kemi kërkuar. Ju po deshët ejani, po deshët mos ejani!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Një minutë ta sqaroj. Kur ta bëni ju seancën dëgjimore, na ftoni ne dhe do të vijmë. Për se shqetësoheni? Përse paskemi frikë ne?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Po shkelni Rregulloren.

Milva Ekonomi – Po çfarë Rregullore po shkelim?!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fidel Ylli – Për procedurë, të lutem Albana, se nuk kam folur fare sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ja vlen të bëj debat.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne mendojmë që të zbatojmë Rregulloren. Ju doni të bëni mbledhje, bëjeni! Por Rregullorja nuk thotë që mbledhja e komisionit të bëhet tek Teatri, por në godinën e parlamentit. Ne i thërrasim të dy, pastaj nëse hyn njëri para dhe tjetri mbrapa, kjo nuk ka rëndësi. Ne jemi të predispozuar që t'i dëgjojmë, sepse janë shumë vendime që ndoshta janë marrë pa dijeninë tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të vijnë këtu 10 veta nga artistët, të bëjmë debat dhe ta diskutojmë projektligjin. Është krejt normale.

Albana Vokshi – Dakord. Ne kemi qenë edhe në spital, kemi bërë mbledhje komisioni me të gjitha palët, pra kemi dalë edhe nga komisioni dhe kemi bërë mbledhje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ne kemi bërë një propozim dhe duke u dakortësuar bashkë të gjithë, kemi shkuar në Spitalin e Traumës dhe kemi bërë disa mbledhje të tilla jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

I keni bërë edhe në Berat, kur nuk ishim ne.

Fidel Ylli – Ne jemi të interesuar që ta bëjmë këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Dakord, e bëjmë këtu.

Milva Ekonomi – Kemi edhe një çështje tjetër. Ariana na ka sjellë një *e-mail* të gjithëve, pastaj na e ka përforcuar mua, Fidelit dhe Albanës, për një gjë tjetër, për një ndryshim të ligjit “Për arsimin parauniversitar”

Milva Ekonomi – Nuk është këtu. Nuk është futur në kalendar.

Milva Ekonomi – Është futur në kalendar me datën 16 korrik.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Prandaj duhet të planifikojmë edhe një takim për ligjin për arsimin parauniversitar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Ka qenë në program dhe jo në kalendar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ishte, sepse e kam kontrolluar unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Ishte hequr dhe pastaj ishte vendosur përsëri, prandaj duhet ta planifikojmë edhe këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Albana Vokshi – Në kalendarin që na kanë sjellë zyrtarisht, nuk ka qenë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

MBYLLET MBLEDHJA

